




Raiffeisen
INVEST

LIVING WITH GENDER EQUALITY

BOOKLET





**Raiffeisen
INVEST**

LIVING WITH GENDER EQUALITY

Ky botim është realizuar nga stafi i qendrës ACT for SOCIETY:

Armela Pengili

Xhoi Bare

Stela Kosova

Nertila Meçani

Realizimi grafik: Anisa Kaso

Ky botim është pjesë e projektit “Living with Gender Equality” të mbështetur financiarisht nga Raiffeisen Invest në Shqipëri dhe të implementuar nga Qendra ACT for SOCIETY. Materialet dhe opinionet e shprehura në të janë të pjesëmarrësve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qendrës ACT for SOCIETY apo Raiffeisen Invest.

"MAMASË"

Të mbaj mend
me lugën në dorë
duke trazuar gjellën
veshur me një palë tuta të babait,
me një legen ngjyrë blu të thyer anash,
me një dorë në brumë ku shpesh të binte unaza;
njëherë kur doli tek copa ime e bukës
ta dhash si dhuratë për 8 mars,
siç të mbaj mend me shatin në krah
e dorën në brez (ndoshta prej dhimbjesh)
sikur më dëshmoje: unë ia dal,
ja, ndër dhëmbë po përtyp vetminë
ja, edhe tënd at, edhe Greqinë.

Të mbaj mend me dy bidona uthulle në duar
që i mbushje me ujë në kroin e fshatit.
Të vija pas për ndihmë dhe të bëhesha pengesë.
Të mbaj mend tek bëje edhe punë burrash
që të rrisje burra.
Ta mbaj mend madje edhe lëkurën e bardhë
që u zhbë befaz si sekuencë filmike.
U bëre burrë për shtëpinë,
baba për ne

dhe grua për burrin.
Tash rolet më ngatërrohen
dhe poezia ma humbet fillin.
Po e lë këtë strofë.

"Do shkosh tek burri"
është fraza që tash ia beh prej teje
sikur po flet për xhelatin.
Burrit dhe jetës së burrit
ia jep trajta të rënda
nga frikë mos gjërat bëhen ciklike.
E di, do që jot bijë mbetet një vajzë
asesi një nuse;
as e ve, as e martuar, as e divorcuar.

Të mbaj mend
tek motrave iu thoje nën dhëmbë
"mos e paçi fatin tim",
e atëherë shashtisja
tek rrokja veç dështime kuptimesh.
Tani them vetë: mos e paçin fatin tënd.

Alban Tufa

“Living Gender Equality/ Të jetosh barazinë gjinore”

Të jetosh barazinë gjinore do të thotë që kjo lloj barazie të jetë prezente në jetët tona dhe të riformësojë realitetin tonë. Ne pretendojmë se në Shqipëri, si një vend demokratik, ekziston barazia gjinore, por sa ndikon kjo lloj barazie në jetët tona dhe cili është impakti që lë në shoqërinë tonë? Përshembull: ne kemi politikanë meshkuj edhe politikane femra dhe në më të mirin e rasteve mund të kemi dhe barazi edhe në numër, por çfarë mund të themi për zërin e tyre? A dëgjohen zërat e politikanëve meshkuj më shumë se sa të femrave? A ka barazi në këtë rast? A u dëgjohej zëri të dyja palëve në mënyrë të barabartë kur bëhet fjalë për vendimarrje apo politikbërje? Po përsa i përket përfaqësimit të meshkujve dhe femrave në media në media? A janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë të dyja gjinitë? Dhe nëse po a kanë një rol të barabartë? Oh jo, në fakt femrat “nuk marrin shumë vesh nga politika” dhe si rrjedhojë prezantuese emisionesh për politikë kemi shumë më pak, në fakt numërohen me gishta - nja dy a tre. Çuditërisht nuk ndodh e njëjta gjë përsa i përket emisioneve sportive: femrat janë mjaftueshëm prezente falë ...si me thënë ... trupit të tyre perfekt, mundësisht përfaqësuese të asaj kategorie të preferuar nga audiencia dhe që ndryshe njihet me trupëzimin/bodyfication kur trupi i një femre shihet vetëm si objekt-mundësisht zbukurues. Dhe meqenëse jemi tek kjo temë e keni vënë re që në shumicën e reklamave në media të ndryshme deri tek billboardat nëpër rrugë imazh kryesore dhe reklamues të produktit janë përsëri femrat ose me saktë trupi i tyre?

Sa lider meshkuj dhe sa femra kemi nëpër kompani dhe nisma të ndryshe? Sa drejtorë dhe drejtoresha kemi nëpër institucione të ndryshme? S’di pse titulli drejtoreshë më çon ndërmend vetëm e vetëm një pozicion të caktuar: atë të drejtueses së një shkollë. Sa sipërmarrës femra dhe sa meshkuj kemi në ditët e sotme?

A ka ende familje shqiptare të cilat luten për femijë djema dhe ngrysen me lindjen e femrave? Po ka sa duash. Po, pikërisht edhe në ditët e sotme!

Këto dhe shumë pyetje të tjera duhet të na shqetësojnë dhe t’i adresojmë atyre që merrin me politikbërje, me përpilime strategjike dhe me lobime të drejtash. Sepse është e drejta e një femre të jetë e barabartë me meshkujt e tjerë në një shoqëri demokratike si e jona.

Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum (WEF)) në bazë të raportit vjetor mbi Hendeku Ndërgjinor (Gender Gap) ka projektuar një aplikacion i cili të mundëson të kuptosh në shkallë kombëtare dhe

ndërkombëtare se sa të barabartë jemi. Mjafton të fusësh emrin e vendit dhe rezultatet të shpjen në disa fusha të ndryshme ku mund të matet Barazia Gjinore. A e dinit, përshembull, se vetëm një në pesë (një përqindje prej 23 %) menaxhere, drejtuese apo lidere janë femra, kundrejt 78 përqind meshkuj? A e dinit se ndër ministra dhe deputetë vetëm 35 përqind e tyre janë femra? Mentalitetet alarmant shoqëruar me shifra alarmante.

Por mjaft u ankuam, se për t’u ankuar jemi të parët ne - e kemi në kulturën tonë të përgjithshme, sikur të na ishte shkruar në gen. Le të fokusohemi tek ajo çfarë konkretisht ne kemi në dorë të bëjmë.

Dihet që hapi i parë për të bërë ndryshim, në çfarëdo lloj fushe dhe hapësire duhet së pari ta nisim nga vetja. Për këtë duhet që të informohemi sa më shumë mbi gjendjen e barazisë gjinore në vend dhe jashtëvendi. Duhet të informohemi sa më shumë mbi politikat të fokusuara në këtë temë dhe se si mund t’i implementojnë këto në përditshmërinë tonë duke filluar nga vetja dhe rrethi më i ngushtë. Mund të informohemi gjithashtu duke marrë pjesë në aktivitete lokale, kombëtare apo ndërkombëtare si workshop-e, seminare, trajnime konferenca etj në lidhje tema që prekin çështjen “Gender”.

Më pas duhet të kujdesemi që informacionet e përfutura t’i përçojmë në rrethin tonë të ngushtë: si në familje, shkolle, vend pune etj. Mund t’i bashkangjitemi fushatave të ndryshme të organizuara nga shoqata që llobojnë për çështjen në fjalë.

Nëse jemi prindër mund t’ja nisim që nga fëmijët tanë: edukimi në moshë të re është shumë efikas për të çbërë atë që shoqëria e prapambetur ka bërë me ne duke na propaganduar ide të gabuara se një fëmijë mashkull është më i mirë dhe më i dobishëm se një femër, se meshkujt mund të bëjnë çdo lloj profesioni ndërsa femrat jonë, se meshkujt janë superheronjë kurse femrat princesha që duhen shpëtuar, se meshkujt mund të lozin me lodra të caktuara apo të veshin ngjyra të caktuara kurse femrat kanë lodrat e tyre dhe ngjyrat e tyre. Këto duken detaje të parëndësishme në pamje të parë por formësojnë mentalitetin e fëmijës dhe ndikojnë në perceptimin e tyre ndaj gjinisë tjetër.

Mbi të gjitha duhet të rrisim ndërgjegjësimin, pasi dikush fillon të ndërgjegjësohet veprimi dhe ndryshimi vjen vetëvetiu!

Denada Dosti


Jeta dhe koha na kanë mësuar dhe treguar se jemi të barabartë me njëri-tjetrin, po ashtu edhe ligji dhe krijuesi ynë. Të gjithë jemi tokësorë, njerëz që marrim frymë, jemi të vdekshëm, atëherë pse duhet të jesh superior/superiore ndaj gjinisë tjetër? Asgjë, thjesht një mendim i plakur që po vdes dita ditës. Një ideologji e gabuar, e lindur, ndoshta e trashëguar brez pas brezi që mashkulli ka më shumë të drejta se femra, apo se është më i zgjuar, apo më i zoti.

Natyra i ka falur femrës dhuratën më të çmuar, atë të vijueshmërisë së jetës, por femra nuk mund ta ketë dhuratë pa pasur një mashkull në krah, mbajtja e familjes, asaj te shëndoshë dhe të lumtur nuk do të ishte e mundur pa praninë e një mashkulli dhe anasjelltas. Nga kjo kuptojmë se si mashkulli dhe femra kanë nevojë për njëri-tjetrin dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Atëherë pse njëri duhet të jetë dominues ndaj tjetrit? S'ka asnjë arsye. Sot në fushën e punësimit kërkohet më i afti, më i zoti, dhe më i përgadituri për vendin e punës, s'ka rëndësi gjinia, rëndësi ka aftësia. Është provuar shkencërisht se profesionet që janë të destinuara vetëm për njerën gjini, ndodhë ajo që nuk pritej as mendohej, do korrtë suksesin më të madh gjinia jo e predispozuar. Liria dhe barazia, dy ideale dhe motive që mundësojnë dhe i japin frymë dhe jetë, jetës së njeriut, i mundësojnë një jetë të qetë dhe të lumtur. Pse njeriut i pëlqen të mos jetë i pabarabartë, por të jetë dominues. Mos vallë ky që nuk don të jetë i pabarabartë

dhe don barazi, kur dominon ndaj dikujt tjetër e shijon tej mase pozitën dhe e shfrytëzon atë, pozita e të dominuarit dhe e më të lartit i jep atij hirin e rëndë të pushtetit, zotësisë, pronësisë, kjo i duket e ëmbël dhe e shijon.

Dashuria për barazi e liri është dashuri dhe një nevojë jetësore me të cilën vishen njerëzit e virtytshëm dhe të sjellshëm. Le të jetojmë të lumtur së bashku duke kërcyer e kënduar, këngen e barazisë, dashurisë për njëri-tjetrin. Të gdhendim në mendje dhe në zemër dhe të përcjellim tek njëri-tjetri atë që duam që të tjerët të përcjellin tek ne, gurin e çmuar të barazisë.

Dorina Petoku





Unë jam Eleni, jam një vajzë njëzetë e dy vjeçare, një punonjëse sociale, unë jam unike, jam motra e vogël, vajza e vogël, më quajnë “e vogla”, “e përkëdhelura”, jam shumë gjëra, jam shoqja e dikujt, partnerja e dikujt, jam një e njohur e dikujt tjetër... unë jam të gjitha këto; por a jam me të vërtetë të gjitha këto?! Ndoshta... thjesht ndoshta... unë jam një vajzë më tepër! Ndoshta jam një tjetër vajzë njëzetë e dy vjeçare që ka studiuar për punë sociale, jam një motër më tepër për motrat e mia, një shoqe më tepër, një më tepër për partnerin tim, por për prindërit e mi nuk jam një vajzë më tepër... apo mos vallë jam...?

Çfarë është më mirë, të pyesësh veten dhe të mos marrësh kurrë përgjigje apo të pyesësh dhe të mësosh të vërtetën? Unë pyeta dhe tani e di të vërtetën. Për prindërit e mi unë nuk jam një vajzë më tepër, por dikur kam qenë. A u lëndova? – pak. A u çudita? – aspak. Në një familje tradicionale shqiptare me dy vajza, një e tretë është e tepërt dhe unë isha e treta, e tepërta, ajo që i zuri vendin djalit.


Në fakt, për time më nuk kam qenë kurrë e tepërt, ajo gjithmonë më ka dashur dhe ka arritur të më mbrojë edhe me anë të gënjeshtërs. Ajo dhe doktori i saj thanë se seksi i fëmijës nuk dallohej nga frika se të afërmit e tim eti – jo ai vetë – e detyronin që të hiqte dorë prej meje. Madje ata kishin gjetur edhe një emër për djalin e shumëpritur! Im atë, nga ana tjetër, e donte shumë një djalë, një “trim” të vogël që ta mbante me vete, që të krijonte një lidhje ndryshe nga ajo që mund të krijojë me një vajzë. Ishte im atë ai që derdhi lot zhgënjimi kur morri vesh se isha vajzë por ishte po ai që më pa, më morri në duart e tij dhe në atë moment më vendosi një emër të cilin unë e adhuroj... Ai nuk na sheh si vajza, ai na sheh si fëmijë, si fëmijët e tij për të cilët do të bënte gjithçka...

Duke menduar, duke shkruar, kujton dhe kupton. Unë tani kuptoj se për kë jam një vajzë më tepër, për dikë i cili më ka parë drejt e në sy dhe thjesht e ka thënë. Kujtoj një fjalë që e kam dëgjuar para dy vjetësh nga nëna e tim eti: “nëna nuk të donte kur linde, por tani të dua shumë”... kjo fjalë më lë pa fjalë. Si mund të mos duash një foshnjë të porsalindur?! Ajo ishte e verbuar nga dëshira për të pasur një nip nga djali i saj i madh por gjithsesi kjo nuk e justifikon. Por ky është edhe

realiteti shqiptar, në të cilin vajzat shihen si barrë e familjes, një anëtar që duhet të “hiqet qafe” me martesë, në mos me ndërprerje shtatzanie. Ndësa djemtë shihen si bekim, si forca e familjes dhe e fisit, por mbi të gjitha si trashëgimtar i pasurisë materiale, por edhe i mbiemrit të familjes, sikur të ketë ndonjë mbiemër kushedi çdo familje!

E rëndësishme nuk është mënyra se si të shohin të tjerët apo se çfarë je për të të tjerët, e rëndësishme është mënyra se si e sheh veten dhe se çfarë je ti për veten tënde. Unë e shoh veten si një vajzë unike. Çfarë më bën mua unike? – nga këndvështimi im, gjithçka! Unë tani e njoh vehten më mire se çdo herë tjetër. Unë e di si jam, kush jam, çfarë dua, çfarë dëshiroj, çfarë do të bëj, por mbi të gjitha unë e di se çfarë nuk jam dhe çfarë jam: Unë nuk jam një vajzë më tepër! Unë jam “ajo vajza”...

Eleni Nanaj



" I vu nana e nuses durt n' maje t' kres'
E ka pas Lulen si n' ven t' res
I vu baba i nuses
durt n' maje t' gjardhit
E ka pas Lulen si n' ven t' gjalit "

Këto vargje , nën tingujt e dajres më kishin dhënë njëfarë gëzimi ku si e vogël arrija të kuptoja se e morëm atë që deshëm, një vajzë të veshur në të bardha që e quajm nuse. Tek e fundit s'kishte si të ndodhte ndryshe kur ne ishim një numër i madh krushqish, me shumë makina, e kjo ishte pika kulmore e gëzimit. Gëzimi që përjetoja ishte i pashp-jegueshëm.

Vite pas për mua është e çuditshme jo se pse nuk shpjegoja gëzimin tim , por për ç'arsye gëzoja?! E njëjta këngë, e njëjta situatë , në një moshë tjetër më trondit, më çon në një gjendje ku më duhet të reflektoj mbi raportet formuese te individit, ato me prindërit dhe jo vetëm por edhe për rolin tim në shoqëri.

Të njohurit e vetes nuk mund të vijë ndryshe përveç se përmes shen-jave të cilat i ka krijuar vetë njeriu , rrjedhimisht shoqëria. Format e teprisë që sjellin artin dhe zakonet të cilat vijnë si domosdoshmëri për njeriun shfaqin edhe mënyrën e të konceptuarit të një rregulli sipas të cilës shoqëria funksionon. Ajo shfaqet përmes kostumografisë, pik-turave , këngëve etj, e kjo është një sh-palosje e njeriut ndaj njeriut, e të vjetrit ndaj të riut, e anasjelltas.

Në nuk jemi genie që kemi privilegjin e të paturit një bote të re tonën, të cilës mund t'i japim formën që duam, sipas parimeve tona si genie të reja. Shkurt, nuk mund të ketë Adam dhe Evë të tjerë. Ajo çka na pret në botë është konflikti , konflikti për të ndryshuar gjendjen (ose botën

) përmes së cilës afirmohemi si ekzistencë, e për këtë duhen subjekte. E, kjo është çështja që na mundon të gjithëve herë pas here, sa ekzist-encë (realitet) kemi ne si subjekte , d.m.th a jemi subjekte?

Si mund të jem reja e shtëpisë për nënën , djali për babain por asnjëherë vajzë e prindërve të mi?! Reja (nusja) e shtëpisë është ndihma që i vjen vjehrrës, për sa kohë vajza është në shtëpi e luan ajo këtë rol , nga ana tjetër është edhe djalë për babain. Ku ? Atje jashtë shtëpisë , tek gardhi, pra të qenët krah pune. E nëse tek prindërit është edhe djalë, tek burri nuk dijm nëse do ketë këtë privilegj ,por ama do jetë re' (nuse) . Këtu mbyllet edhe qarku sepse jemi brenda një rrethi vicioz në të cilin ndryshojnë njerëzit por jo skema. Pra, vajzat thjeshtë ndry-shojnë pronarët.

Kjo çështje me të drejtë mund të konsiderohet si sëmundje e trajtuar dhe shëruar , por bëjme gabim nëse e konsiderojmë si të zhdukur. Për sa kohë vëmë re simptoma të saj, qoftë edhe në raste të izoluar kjo mund të çoj në një riformulim të saj, si një trajtë e re asaj çka ishte më parë. Le të jem më e qartë. Siç thashë dhe më sipër ne trashëgojmë konfli-kte, e kjo nuk duhet marre si diçka problematike ,por si një avantazh që kemi në botë, problematike është mënyra se si ne i qasemi konflikti. Janë tre mënyra se si mund të "konfliktohemi" , e para është ballore , ku kjo nënkupton edhe betejën me një fitues dhe humbës, ku për nga ajo çka sjell e reja them që mund të sjellë përmbysje. Dy mënyrat tjera për nga natyra nuk janë plotësisht konflikte, por më shumë pakte ose nën-shtrime të palëve, ku mënyra e dytë është më shumë si një marrëveshje e të resë me të vjetrën ku secila prej tyre ka nga pak frikë nga tjetri , zgjedhin të ecin sëbashku. Në mënyrën e tretë e reja zgjedh të mbaj të vjetrën si prijëse, ku kjo është një formë nënshtrimi.

Duke iu rikthyer problemit që hapëm në fillim, e duke u munduar t'i japim një përgjigje, nëse sëmundja është zhdukur apo thjesht është trajtuar, e që mund të ketë marrë një formë tjetër. Pyetja që lind është “A bëhen vajzat reja, rejat vajza apo vajzat janë bërë vajza?” Besoj se përgjigjja nuk ka nevojë për referenca ose matje por mund të përgjigjemi lirshëm duke thënë se vajzat tani janë vetëm vajza. Ajo nuk shikohet si një objekt ndaj të cilës priten përfitime por është një qenie ndaj të cilës ofrohet dashuri, e përkushtim dhe mendohet për formimin e saj. Ajo vetë është e angazhuar të bëhet grua.

Këtu dua të bëj një ndërhyrje të shkurtër për të qartësuar dicka që duhej ta bëja në fillim, situatat që po analizoj nuk mund të merret si tërësi e gjithë kategorisë, kjo për arsye se për të njohur një fenomen ne duhet të shkojmë aty ku kemi intensitetin më të madh të shfaqjes së saj, pra, aty ku simptomat janë në shfaqjen më të plotë të tyre. Interesante e këtij intensiteti të zonës tregon dy gjëra, e para shkallën më të lartë të shfaqjes dhe së dyti, mundësinë e një krisje/çarje.

Për të vazhduar më tej na duhet një gjendje tranzitore në të cilën mund të shquash gjërat nga paqartësia që i karakterizon. Një gjendje e tillë është pikërisht faza e studimeve. Arsimimi i vajzave mund të ketë shumë interpretime, filluar nga vetë prindërit. Për disa është një përjashtim, kjo shprehet: “Na detyroi ta çojmë në shkollë se mësonte se nuk kishim kohë të merreshim me të tilla gjëra.” Pra, është përjashtim që po arsimohet se në të zakonshmen do qëndronte në shtëpi, e meritonte, e mori me zor se përndryshe nuk do kishte arsimim, a thua se arsimimi është zgjedhje prindërore e jo një e drejtë individuale. Për një pjesë tjetër relativisht të madhe arsimimi i vajzës është një kohë e lirë, e tepërt deri në ardhjen e kandidatit të denjë për martesë, ndërkohë vajza “kualifikohet”. Por nuk dua të qëndrojmë shumë në këtë pikë se konsideroj më të rëndësishme atë që vjen më pas, fillimi i arsimit të

lartë dhe zhvendosa drejt qyteteve të studimit. Kur them këtë besoj edhe ju si mua ju përfytyrohet konvikti, ai i vajzave dhe banoret e saj, konviktoret. Ajo godinë që ngjan si koshere bletësh e mbi të cilat vërshojnë epitete, batuta e gjithëfarë gjykimesh. Në të gjitha rastet është konviktorja, asnjëherë konviktori.

Mes të qenit vazhdimësi e një rruge të projektuar dhe të ndjekurit e rrugës që do ngrihej nga ajo si subjekt i duhet të kaloj edhe përmes lupës së shoqëris si matës vlerash. Prindërit kërkojnë të jetë nderi i tyre. Dashuria nuk është tabù, e nese prindërit e tu e konsiderojnë të tillë, bëju të ditur që ti je individ përpara se të jesh “nderi i familjes”.

Mos u meso te heshtesh.

Revoltohu.

Reago për të drejtat e tua.

Ky vend i do të shtypura e të nënshtruara femrat por ti mos u bej e tillë.


Duaje veten tënde.

Sepse ti o e dashur, je inspirim!

Je poemë.

Nga ato që ta mbushin shpirtin me lule plotë.

Adelina Onuzi



Çfarë është jeta në thelbin e saj?

Të qenit të njëjtë në këtë botë.

Jeta është një mister ?! Kjo është një ndër pyetjet që qarkullon në mendjet e çdokujt.

Është e tillë sepse ende nuk kemi arritur të kthejmë përgjigje, çfarë është jeta në thelbin e vet.

Por vallë a e dimë ne pse jetojmë ?! A e dimë në pse vallë u zgjodhëm ne për të jetuar në këtë botë kaq të çuditshme, kaq ogurzezë ?

Normale që jo ! Janë pikëpyetja më e madhe .Çdo kush prej nesh nis një udhëtim imagjinar, një udhëtim drejt një bote të pakufijhtë, ku gjithçka është misterioze.

Por në ditët e sotme kemi shumë vepra në të cilën çdo autor me një ndërthurje mjaft të veçantë, mjaft unike që u bënë ngjarjeve, na bën më fiksues të saj.

Secili autor na jep na jep një mesazh mjaft të veçantë që jo të gjithë do ta kuptonin:

“Jeta është dhuratë e çmuar, shijoje“, normal, jo për të gjithë ! Jo për të gjithë sepse shumë janë të poshtëruar, janë të detyruar ta jetojnë atë jetë sipas rregullave që dikush tjetër vendos. Janë të detyruar të vazhdojnë të ecin duke lënë pas shumë valixhe të tyre për t’u nisur drejt udhëtimit të detyruar “magjepsës”. Si çdo gjë që nis për një qëllim, ashtu dhe jeta fillon dhe kështu do të përfundojë, por jo domosdoshmerisht kuadri i saj i së drejtës të përfundojë. Shpesh lihet pezull.

Lihet pezull nga ata që konsiderohen të dobët, ose le të themi nga ata të cilët janë lodhur dhe kanë hequr dorë nga “beteja e pafundme e ekzistencës”.

Jeta është krijuar e tillë me një kuptim të cilin nuk e kupton asnjëherë. Mund ta quajmë si të duam, mund ta quajmë dhe mëkat por bërthamën e bërthamës nuk kemi për ta gjetur asnjëherë.

Ama për sa kohë kjo botë është krijuar, për sa kohë ky planet do të ekzistojë të gjithë kanë ardhur, po vijnë, dhe do të vijnë me një qëllim i cili nuk është vetëm shijimi i jetës.

Por vallë pse jeta është si një piramidë? A e dini pse? Sepse bota ka hipokritë, ka shumë persona të cilët mendojnë se janë gjithçka ndër kohë që nuk janë asgjë, por janë thjesht personat më të cekët se të gjithë të tjerët, të cilët përfitojnë nga disa njerëz në nevojë, nga disa njerëz që mbyllen në vetvete sepse mendojnë se kjo botë nuk është për ta.

Pse ekziston mosbarazia gjinore dhe racizmi?!

Racizëm? Mosbarazi? A e dini, a ekziston në mendjen e çdokujt që janë gjërat më absurde?! A ekziston kjo gjë vallë, që jeta është e njëjtë për të gjithë?! Normal që jo, sepse i’u duket vetja më të lartë, i’u duket sikur gjithçka në këtë botë rrotullohet rreth tyre. Por ende nuk e kuptojnë që jetojmë në një botë me rregulla , jetojmë në një botë ku rregullat nuk janë shkruar sot, por ndodhen të fshehura diku dhe jemi ne ata që duhet t’i zbatojmë. Jemi ne ata që në këtë botë duhet të jemi të bashkuar për të qenë NJË të vetëm, të përballemi para çdo gjëje... Ngjyra nuk tregon asgjë, thellësia e shpirtit flet më shumë se gjithçka.

Ashtu si mashkulli dhe femra është një qenie pa të cilin ky planet nuk do të kishte kuptim, çdo kush prej nesh e ka një rol dhe të jesh femër nuk do të thotë që ti je në një nivel më poshtë se meshkujt. Jo aspak, sepse të gjitha gjërat arrihen. Femra është një qenie e brishtë, një qenie

e cila vërtetë kërkon dashuri, ama është e vetmja qenie që ia del mban e vetme.

Prandaj femër e dashur mos harro! Vazhdo të luftosh deri në fund sepse do të vijë një ditë që do shuhet kjo botë, ky mentalitet “makabër” dhe atëherë do të jesh e lirë që ëndrrën tënde ta bësh realitet. Pas një nate të errët dielli lind sërish. Por derisa kjo natë të kalojë mos u ndal së ëndërruari, derisa kjo ditë të vijë mos e ndal hapin pasi rreth teje janë të gatshëm shumë për të të ndaluar sërish.

“Jeta për ta është një sfidë”. Hapi drejt një rruge të ndryshme nga kjo, do të ishte akoma më shumë magjepsëse e surprizuese. Por etja, egoja dhe kurioziteti, edhe shumë të tjera, e prishin këtë “portë” dhe e detyrojnë të vazhdojnë drejt “portës” së tyre. .

Ndërsa për shumë të tjerë, ky udhëtim nuk mbetet imagjinar, por real. Jeta është vërtetë një përrallë, një përrallë të cilën duhet shumë për ta plotësuar.

Është një det i trazuar, është një makth por ndonjëherë dhe ëndërr e vërtetë, është një jetë që duhen shumë sakrifica për të kuptuar thelbin e vërtetë.

Janë qat kuti për të plotësuar këtë pazëll sa ndonjëherë të lodhin, dorëzohesh...

Janë disa kuti të cilat janë forca më e keqe. Por në momentin kur ti kupton nëse “Jeta është e drejt apo detyrë”, që të gjithë jemi një, në momentin kur pazëlli ka përfunduar, aty dhe boja për përfundimin e veprës ka përfunduar me fjalën e vetme “Fund” .

Ne jemi dhe do të mbetemi lojtarë të jetës sonë. Çdokush prej nesh. Prandaj të qenit zemërmirë dhe syhapur para kësaj bote do të ishte një dallgë më pak. Në një det të pistë askush nuk do dëshironte të futej,

ndaj duhet të jemi ne ata që të mos e ndotim këtë det, duhet të jemi ne ata që edhe nëse ka ekzistuar kjo përlule gjinore e gjithçka tjetër, ta heqim sot për të jetuar një botë ashtu si duhet.

Argida Shabani

"Eunoia"

(një mendje e bukur,
të menduarit mirë)

Universi kur shpërtheu,
Di që krijoi dashurinë,
Që shpirtrat ti mësojë
Si të lundrojnë në liri!

Në portën e botës trokita,
Më dhanë një trup, e një gjini,
Një emër e një shtepi ,
E krahë që më mbanin në gji!

Shpirtin sma trazoi njeri,
Ma ledhatuan me mirësi ,
E ushqyen vecse me dashuri,
Derisa erdhi një ditë.....

Ajo ditë kur të roberojnë
Shpirtin ta dëbojnë
Je burrë të thonë,
Mos qaj, mos ndiej të thonë

E kalojnë ditët po të njëjta,
Unë jam ai , e ajo është e imja,

Robëresh e gjenitaleve të mia.
Pabarazia e ekuacioneve te mia.

Unë e ndiej se jam gabim,
Por mos ndiej më thonë,
Ndryshe s'do jesh burrë ,
Burri që ne kërkojmë,

Une jam një Burrë ,
veç egoist e dominant,
që shpirtin e humba,
kur më thanë bëhu djalë!

Por unë sdoja të isha djalë,
Por thjesht një njeri,
Me shpirt të mbushur me dashuri,
Që qan e qesh e luan si çilimi!

E bota një ylber ,
Që ka vetëm pranverë ,
Kur ai dhe ajo,
Është ne dhe lumturi!

Bjorna Hoxhallari

Në një trup të huaj

I

Po më flet për barazi gjinore
Aty ku shumicën e shkëlmojnë
Dhe i trajtojnë sikur fëmijët
Në jetimore
Mentaliteti jonë
Shumë i ndrydhur
Dhe me shpatë e parzmore
Sikur duan t'i therin
Këto krijesa
Të sapo lindura
Dhe t'i hedhin nëpër pellgtore

II

Barazi gjinore
Ose të jetosh
Me këtë komunitet
Jo nuk kam parë
As un e as ti
Nuk i mbështesim
Edhe pse përbrenda janë të vrarë

III

Kur shumica marrin rrugët
E ikin me plaçka
Nga shtëpia duke qarë
Se familja nuk e përballon dot
Këtë brengë që i ka lënë hapur
Fëmija e tyre
Shtegtar

IIII

E përse duhet t'i mbështesim thonë
Shumica si unë
Nuk janë asgjë tjetër
Veçse degjenerim i këtij vendi
Që po lulëzon pak
Më shumë

IIIII

Unë nuk dua të jem paragjyquese
Të jetosh me barazinë gjinore
Prapë do të ishte diskriminuese
Edhe pse përçmuese
Pak se nga çka

Të gJORËT nuk kanë faj
Pse lindin me ndjenja
Për gjininë tjetër
E shumë tunduese

IIIIII

Fundja fundit
Jemi qenie humane
Unë ti dhe ai tjetri
Të respektojmë
Të drejtat e gjithkujt
Se fundja fundit
Asgjë nuk mbeti
Nga pak se çka
Të tillë njerëz
Akoma jetojnë me frikën
E me mantelin e padukshëm
E hiqen sikur i gjithë mileti
Kur përbrenda janë ndryshe
Nga lëkura që kemi
Une ti apo
Ai tjetri!

Doris Kasaj

Living with gender equality

Është më tepër se një koncept. Barazia gjinore është një ëndërr e cila u shfaqet të gjithë atyre të cilët jeta i ka dënuar për të jetuar në një mjedis plot injorancë. Edhe unë e ëndërooj një botë ku të ndihem e barabartë me shokun tim të ngushtë, me vëllaun tim, apo me partnerin tim të jetës. Por jo, ne vazhdojmë të qëndrojmë të dashuruar me kultin e zymtë të asaj që sapo përmendëm, injorancës.

Ime më vazhdon të bëjë punët e shtëpisë, ndërsa babai ka një profesion dhe siguron ekonominë e shtëpisë në vend se të dy të kenë një profesion dhe babai të ndihmojë ndonjëherë mamin për të gatuar pa atë idenë që do i bie ai autoriteti burrëror. Vëllai im vazhdon të më përjashtojë mua nga mundësia për të marrë përgjegjësi, për të qënë më e gatshme për të jetuar e pavarur nga të tjerët. Më përjashton me idenë se disa gjëra nuk i bëj dot vetëm se jam femër. Edhe ai miku im më largon ndonjëherë nga biseda dhe nuk më bën pjesë të vendimeve që merren. Pra vetëm për shkak të një të mallkuare gjini që na ndyshon, do të thotë që duhet të vuaj unë më shumë se ti apo anasjelltas. Do të thotë që unë do jem gjithnjë e varur nga ti apo jo? JO. Kjo nuk mund të mbetet kështu përgjithmonë. Nënata tona një ditë do jetojnë të lumtura dhe çdo gjë do e bëjnë së bashku me baballarët. Unë do marr përgjegjësi dhe do mësohem se çdo të thotë të përballesh me vështirësitë e jetës, dhe këtë do ma lejojë im atë, im vëlla por dhe ai miku im që shpeshherë më shmangte. Unë do jem një njeri me të drejta të barabarta me të tuat. Dhe unë do arrij të krijoj një kult të ri të vetvetes time. Ndoshta nuk do të jetë përfekt por do e mbaj larg injorancës. Dhe unë deri nesër do kem një profesion dhe do të marr shumë

përgjegjësi por më e rëndësishmja është se një ditë do të jem prind, dhe si i tillë do jap maksimumin tim për të mësuar fëmijët e mi si të krijojnë një botë të tyre me barazi gjinore, sepse e di se sa dhemb të ndihesh ndryshe. E di sa dhemb të dëshirosh të mos kishe lindur kjo që je. Por pse ndodh kështu? Pse i bëjmë njerëzit të heqin dorë nga vetbesimi? Në këtë mënyrë ne po i detyrojmë njerëzit të urrejnë jetën dhe veten e tyre. Dhe kur njeriu humbet dashurinë ndaj vetes ku mbetet sensi i jetës?

Ka shumë njerëz që shkruajnë një skenar të tillë por ne nuk duhet ta lejojmë këtë skenar të vihet në skenë. Nuk duhet të lejojmë që shoqërisë t'i jepet një trajtë kaq e pakuptimtë dhe kaq e zymtë që nuk mund të kthehet më në gjendjen e mëparshme. Duhet të veprojmë që tani, që në momentin kur gjindemi para realitetit. Nuk mjafton vetëm të flasim apo vetëm të këshillojmë. Duhet të përpiqemi të jemi shembull pozitiv për respektin ndaj një qenie të mrekullueshme siç është njeriu. Sepse të gjithë të tillë jemi. Të gjithë marrim frymë, të gjithë kemi nga një zemër që rrah pa reshtur, të gjithë qajmë, qeshim, shqetësohemi por dhe gëzoheми. Të gjithëve na rrjedh gjak nëpër vena. Kemi kaq të përbashkëta por akoma gërmojmë në fund të humnerës për të gjetur dallimin mes nesh.

Edona Madani

" Gruaja është
një mrekulli."

Gruaja është një mrekulli
qe ekziston ne çdo shtëpi.
Është një nënë ku gjen ngrohtësi,
është një motër që fal dashuri.
Është ajo që ti së vlerëson ,
është ajo që ti e përçmon.

Fatkeqësisht jetojmë në Shqipëri,
ku kjo mrekulli përbuzet në shoqëri.
Jetojmë në një shtet,
ku paragjykimi nuk ka kufi,
qoftë në jug ose në veri.

Çdo shtëpi duhet të lindë një djalë
që pasurinë vajza mos ta marrë.
A thua se vajzat kanë nevojë për pasuri,
zemra e tyre është e larë me flori.

Vajzat pa dëshirë i martojnë
që familje të krijojnë .
Kjo është shoqëria jonë
të tregoj përralla së kam zakon .

Duhet kjo shoqëri të emancipohet ,
duhet forcat të bashkojmë,
barazinë e vërtetë të fitojmë.
Edhe pse jetojmë në demokraci
dita ditës po luftojmë në këtë shoqëri.

Esmeralda Zylali

Ekuilibri i thyer i një peshoreje!

Vite e dekada që ecin pandaluar me ritmin e kohës. Diskutime e debate, ligje që miratohen e që mbesin veç të tilla sepe drita e zbatimit është gjithnjë e zbehtë në vendin tonë. Femra kjo ikonë e bukurisë dhe brishtësisë në të cilën natyra dhuroi me bujari shumçka e mbi të gjitha e caktoi atë si jetëdhënëse që dërgon përpara zinxhirin e jetës, qëndron përballë fortësisë mashkullore në pozita të ndryshme duke patur midis tyre ende të thyer shenjë e barazimit.

Përse vallë qytetërimet europiane e lanë pas me kohë stigmen ndaj femrës dhe mundën ta kthejnë respektin ndaj saj në kolonën zanore të ditës?

Përse kjo vorbull nuk na përfshiu edhe ne, apo ndoshta ne kemi orën tonë që ka ritmin e saj të përgjumur?!

Përse tek ne gjërat janë të destinuara të mbesin në letër dhe a mjaftojnë vetëm fjalët për ta ndryshuar një realitet?

Pikëpyetje të forta që më tepër se përgjigje kërkojnë punë prej të cilës të derivojë një zgjidhje, zgjidhje e cila të mund të ndryshojë shijen e hidhur të një realiteti kokëfortë.

Rrënjët e thella të pabarazisë në shqipëri janë aq të vjetra sa ndoshta puna sipërfaqësore nuk arrin dot të depërtojë e të pasqyrojë ndryshim. Shpirti i femrës është liri që nuk vdes kurrë, ama jeta e një gruaje në shqipëri është liri që vdes akoma pa lindur.

Të drejta të parespektuara është pak të thuash. Simbolika e 8-marsit tek shumë prej tyre nuk shfaqet fare, as në formën e protestës ashtu siç realisht do duhej të ishte e aq më pak akoma në formën e festës. Është mjeruese, por njëkohësisht e vërtetë të thuhet se si hija e stigmës diskriminuese e

përndjek femrën shqiptare që në gjenezë akoma pa lindur, kur në emër të të qenit femër ajo abortohet pa e parë ende dritën e diellit. Dhe përgjigja është heshtje, harresë e brenga e shpirtit të një nëne që nuk guxon të flasë.

Familja ajo që është quajtur bërthama e shoqërisë presupozuhet që duhet të jetë vendi ku afeksioni të mbizotërojë, oazi i qetësisë shpirtërore e mendore dhe strehëza e ngrohtë ku përtej çdo gjëje ndjehesh i kuptuar. Në sa e sa familje ky ekuilibër është prishur, dominon agresiviteti mashkullor, gruaja nuk ka të drejtë vendimmarrjeje dhe më keq akoma është objekt i një dhune verbale e cila jo rrallë përshkallëzohet edhe në atë fizike.

Shkallën e pabarazisë e thellon shpesh fakti kur vajzat adoleshente në vend që të rriten, për njëmijë e një arsye që nuk varen nga vetë ato bëjnë fli ëndrrat e tyre në emër të një martese që nuk e pranon as ligji, i cili duhet thënë është vetëm një fjali e shtypur diku në një bllok të quajtur Kodi i Familjes. Është e rëndë pesha e unazës në dorën e saj, aq sa jeta në supe të brishta e të pamësuar me pesha të rënda. Në mendjen e saj ndoshta kishte projektuar të ulej në auditorin e një universiteti, por jo, ajo tashmë është martuar me shkuesi dhe është nusja e një djali shumë vite më të madh se ajo, në dasmën e të cilit kërciti edhe pushka se kështu e do zakoni kur marton djalë shqiptari, pavarësisht se ngajmë sikur kemi ngatërruar shekull.


Ama stigma bëhet rrënkethëse kur krimi godet familjen duke bërë që gruaja të jetë viktimë. Xhelozira që në vend të divorceve përfundojnë me marrje jete, vrasje që media

i cilëson rëndom si krime pasioni janë ulëritëse për veshët tanë duke na bërë shpesh të mendojmë sa të thella e të vështira për tu kuptuar janë labirintet e mendjes njerëzore. Trumbetim me të madhe, kryesisht në panele emisionesh televizive, diskutime dhe prap përsiatje të kota përballë një realiteti të njëjtë. Marrshime e tubime kryesisht me nismën e përfaqësuesve femra të politikës, që prap se prap megjithëse kalojnë vitet, mbeten në një përqindje minimale përfaqësimi. Nuk duhet harruar se protestat e tubimet në këtë vend bëhen vetëm kur ngjarjet kanë marrë përmasa galopante dhe pasojat janë të parikuperueshme dhe më e keqja janë si flaka e kashtës shuhen shpejt duke lënë pak vetëm hirin e harresës.

Ky është realiteti ynë i deritanishëm që nuk dihet edhe për sa do zgjasë. Peshorja priret të jetë e njëanshme për sa kohë hallkat që formojnë zinxhirin e një shoqërie bashkëkohore janë të këputura.

Një jetë e pajetuar është gjëja më e frikshme në këtë botë! Do na duhet të flemë se mbase në ëndërr shohim një realitet tjetër, apo më mirë të zgjohemi nga apatia e përgjumjes kolektive....

Franceska Hila



Living with gender equality- Të jetosh me barazi gjinore

Për shumë shekuj barazia gjinore është konsideruar si molla e ndaluar e Adamit. Ishte një ëndërr e paprekshme për femrat dhe një veprim i ulët për meshkujt. Patriarkati ishte baza e jetës dhe ky besim rritej dhe zhvillohej në të gjitha shtresat e shoqërisë. Shqipëria është një shtet viktimë e padijes për shkak të izolimit për shumë vite, por kjo nuk do të thotë se zhvillimi që ne kërkojmë s'do të vijë kurrë. Në kohën ku ne jetojmë gjërat janë thjeshtësuar dhe informimi është fusha më e rëndësishme e jetës. Sot ne jetojmë në shekullin e XXI dhe jemi të aftë të kuptojmë çdo gjë. Ne dimë se çfarë është barazia gjinore dhe e kërkojmë mbështetjen e saj në çdo fushë të jetës. Ne duam që barazia gjinore të përhapet por nuk përpiemi. Ne ëndërrojmë për të por nuk ngremë zerin aty ku duhet. Ne duam liri por nuk e kërkojmë atë. Ne duam të na ndihmojnë por nuk përpiqemi të ndihmojmë veten. Keto fakte të vogla të cilat nuk duam t'i pranojmë na bëjnë ne ndryshe nga të tjerët, duhet të bëjme gjithçka për qëllimet tona pasi ne për këtë jetojmë, për lumturinë.

Të bashkëpunosh me ActForSociety është një nga privilegjat që ka një grup adoleshentësh në qytetin tonë. Nisma e kësaj qendre është diçka ndryshe për shoqërinë tonë veçanërisht për Shqipërinë e cila akoma dhe sot vazhdon të qëndrojë në kornizat e jetës dhe zakoneve të vjetra. Vetë qëllimi është edukim, pune dhe ndryshim. Edukimi ynë për të punuar mbi atë që ne duam të ndryshojmë, jetën tonë dhe të brezave që vijnë pas nesh. Kjo është një nismë e cila duhet të përhapet me çdo mjet të mundshëm pasi sado e pavlerë të duket në sytë e atyre që nuk duan ta

besojnë, kurrë nuk është vonë të mësosh më tepër mbi jetën dhe veten.

Kjo që ne kërkojmë për një pjesë individësh konsiderohet e tepërt dhe pa baza morale por për një pjesë tjetër e cila është në rritje konsiderohet domosdoshmëri. Ne jetojmë me barazi gjinore, ne e dimë se ajo ekziston dhe ndjehemi të lumtur kur shohim se ajo po fiton pozita më të rëndësishme në përditshmërinë tonë. Të flasësh është e lehtë, pjesa më e vështirë është të vendosësh atë që thua në zbatim dhe gjithçka për të cilën kemi nevojë është guximi dhe të mësuarit. Guximi nuk është një cilësi të cilën ti e bart gjatë jetës, guximi mund të fitohet ose dhe të humbet, ndaj dhe ne duam që ky guxim të përhapet dhe të fitojë zemrat e të gjithëve për të treguar një të vërtetë të thjeshtë, ne jemi njerëz dhe gjinia jonë nuk na ul apo ngrë vlerat më lart.

Ne jemi ndryshe. Ne do të sjellim ndryshimin, ne jemi e ardhmja dhe nuk do të ndalemi përpara tabuve, pasi tabutë janë ato të cilat kanë ndrydhur breza me radhë të arrijnë suksesin. Barazia gjinore nuk ndihmon vetëm femrat, barazia gjinore është vendi ku meshkujt dhe femrat bashkohen dhe ndihmojnë njeri-tjetrin në jetë, sepse pa bashkëpunim nuk ka sukses.

Geraldo Kacani

HAPAT E MËDHENJ NISIN NGA ATA TË VEGJËL

Është viti 2018, shekulli 21. Është shekulli ku parashikohet se njerëzimi do të bëjë hapa të mëdhenj e me shumë siguri do të arrijë ëndrra të cilat ka mijëra vite që i sheh si udhëtimi në hapësirë për të zbuluar botë të reja, zgjatja e jetës së njeriut duke mundur ligjet e natyrës, makineri të ndërtuara në një formë që paraardhësit tanë të afërt nuk mund as ti ëndërronin e shumë e shumë të tjera.

Është viti 2018, shekulli 21 dhe ne po ëndërrojmë të tejkalojmë veten e të bëhemi zota mbi toke me hapat që po hedhim. Por... a janë këto hapa vërtet të rëndësishëm kur është viti 2018 dhe ne ende nuk kemi barazi gjinore?

Ndoshta u futa shumë shpejt në të ardhmen që ne të gjithë dëshirojmë për shoqërinë ku po rritemi. Ndoshta më parë duhet të shohim pak historinë dhe ato që kanë ndodhur ndër shekuj për këtë temë kaq të nxehtë në shekullin e fundit dhe që vazhdon ende sot.

Koncepti i barazisë gjinore është një fenomen relativisht i ri. Deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, gratë trajtoheshin si inferiore dhe ishin të përjashtuara nga jeta publike e sidomos nga fusha të tilla që kishin të bënin me politiken, arsimin dhe shumë fusha profesionale.

Historia e lëvizjes për barazinë gjinore është një histori intelektuale, politike, sociale dhe ekonomike e marrëdhënies në ndryshim midis burrave dhe grave e cila shpesh është e përfaqësuar në mënyrë të shtrembëruar si lëvizje “feministe”.

Që në kohët e lashta, në Greqinë helenike, gratë shiheshin si të dobëta dhe vetëm për të kryer një funksion, riprodhimin. Me lindjen e feve të reja kjo diferencë u thellua akoma më tepër. Në Krishterim gruaja shihej si mëkatarja, ajo që lindi si inferiore sepse u krijua nga brinja e Adamit dhe që kreu mëkatin më të madh të njerëzimit.

Në shekujt që pasuan, gruaja, gjithmonë mori format më të dobëta në sy të shoqërisë. Ato shiheshin si të papërsosura, të dobëta fizikisht, nuk kishin vetëpërmbajtje dhe intelekt për tu përfshirë në jetën politike apo fusha të tjera të cilat ishin njësuar gjithmonë me burrat.

Edhe pse kjo pamje historike është e zymte, historia ka njohur shumë njerëz të cilët besonin ndryshe dhe i kane kështuuar jetën këtyre besimeve.

Kristina de Pisan (1430) ishte një shkrimtare e cila u lind në oborrin mbretëror francez. Ajo shpesh quhet dhe si “gruaja e parë proto-moderne” për shkak të shkrimeve dhe qëndrimeve të saj. Ajo dha kontributin e saj me anë të veprave të saj si “Libri i Qyteteve të Zonjave”. Për Kristinën, pabarazia gjinore nuk ishte për shkak të dallimeve të lindura mes burrave dhe grave. Në vend të kësaj, ajo e njohu rolin e arsimit dhe të mundësive si shkaktarin kryesor: “Po të ishte zakoni të dërgonim vajzat e vogla në shkollë dhe t’u mësonim të gjitha llojet e subjekteve të ndryshme atje, siç ndodh me djemtë e vegjël, ato do të kuptonin dhe mësonin vështirësitë e të gjitha arteve dhe shkencave po aq lehtë sa djemtë”. Ajo

kishte një qëndrim të ashpër ndaj traditës së misogynisë që mbështetej në diskutimet letrare, fetare apo dhe filozofike. Ajo hodhi bazat për 'taban' të ri të letërsisë dhe historisë në të cilën gratë janë po aq të rëndësishme sa dhe burrat.

Virxhinia Woolf (1941) ishte një nga ato gratë që mendonin se roli i grave në letërsi ishte shumë i vogël dhe se raftet e librave ishin të mbushura nga librat e shkruar nga burra të cilët jepnin një pasqyrë të shëmtuar të grave.

Eleanor Roosevelt ishte një tjetër shembull e cila ende sot frymëzon shumë gra dhe burra anembanë botës. Zonja e parë nuk ishte vetëm një figurë mbështetëse për burrin e saj president. Ajo ishte një aktiviste e cila hodhi bazat e para për Deklaratën e Të Drejtave të Njeriut. Një revolucion për kohën dhe një domosdoshmëri që në shohim ende sot.

Emra të tjerë të rëndësishëm si Alice Paul, Maud Wood Park, Mary McLeod Bethune, Rose Schneiderman, Sojourner Truth, Ida B. Wells, Dorothy Height, Patsy Mink, Dolores Huerta, Wilma Mankiller, Molly Dewson, Margaret Sanger e të tjera, janë figura të cilat kanë dhënë një ndihmesë të veçantë në të drejtat e grave si dhe në vendin që ato duhet të kenë në shoqërinë tonë.

Por a janë vetëm gratë të cilat kanë luftuar për këto të drejta? Sigurisht që jo.

Shumë figura mashkullore, ndër shekuj, mendonin se barazia gjinore ishte diçka që duhej me patjetër të ishte. Qeniet njerëzore janë të barabarta dhe nuk duhet të diferencohen

për asnjë arsye dhe këtë e mendonin Frederick Douglass, John Stuart Mill e deri tek aktivistët e sotëm.

Gruaja është e barabartë para ligjit, ashtu siç është dhe burri. Nisur nga kjo lind një pyetje e cila nuk ka pasur kurrë përgjigje shekullin e kaluar ku dhe kanë lulëzuar shumë të drejta dhe ligje për të rregulluar të drejtat në shoqëri; pse ende ka pabarazi gjinore?

Ky shekull ka nisur me lëvizje të mëdha për të sheshuar këto pabarazi. Aktivistë të ndryshëm, nga të dyja gjinitë, po punojnë në fusha të ndryshme për të ndryshuar perceptimin e grave në shoqëri. Ende ka shume pune. Ende ka pabarazi në arsimin e tyre, në politike, në filozofi, në shkencë e në shumë fusha të tjera. Ende shoqëria ka nevojë që të ushqehet me faktin natyror se çdo qenie njerëzore është e barabartë me çdo qenie njerëzore tjetër pavarësisht ngjyrës lëkurës, prejardhjes, orientimit seksual dhe sidomos pavarësisht gjinisë.

Ende ka pune të mëdha para se ne të pushtojmë hapësirën, para se të kalojmë dhe vetë natyrën duke zgjatur jetën, para se të bëhemi zota në tokë e jo vetëm.

Igli Myftarlli

Barazia gjinore

Të flasësh për këtë temë, të mendosh, të kesh këtë temë të fluturojë në mendje, në çdo bisedë, dhe në cdo bashkëbisedim tanimë mund të quhet tepër klishe dhe tepër bazike në një farë mënyre. Duke qenë adoleshentë, mendojmë se jeta jonë nuk është perfekte, madje madje është totalisht jashtë perfekte. Mendojmë se problemet tona vetëm shtohen, por ndoshta është problem më i madh që i shton të tjerat dhe unë do t'ja veja fajin më të madh pabarazisë gjinore. Le të tregohemi të sinqertë, studiojmë në një nga gjimnazet më të mëdha të vendit, në qytetin më të madh të vendit dhe përsëri ndjehet aroma jo aq e mirë e pabarazisë gjinore. Dallohet në shkallët për në shkollë, dallohet kur ngrihesh në dërrasë për të thënë mësimin për të cilin ke pasur kaq kohë për ta mësuar, pa barazia gjinore dallohet rrugëve të kryeqytetit, dallohet deri në jetën e përditshme. Por sa do të doja ta ndryshoja...

Mund të them në mënyrë krenare se sa e zhgënyer jam nga bashkëmoshatarët e mi të cilët me krenari e tregojnë pa barazinë gjinore. Shumica prej tyre ose janë shumë të informuar dhe nuk duan ta zbatojnë në praktikë, ose ka vërtetë nga ata që janë të paditur dhe nga kjo bëjnë veprime të pa kontrolluara.

Rolet që burrat dhe gratë luajnë në shoqëri janë të përcaktuara shoqërisht dhe si rezultat, hendeu gjinor është i gjerë. Në mënyrë stereotipe, gratë janë të njohura si ato që qendrojnë në shtëpi dhe gatuajnë dhe pastrojnë ndërsa burrat janë në punë duke fituar para. Megjithatë, rolet gjinore në

shoqëri vazhdimisht ndryshojnë. Pikëpamjet tradicionale të burrave dhe grave kanë ndryshuar gjatë viteve. Kontrastet midis roleve gjinore konvencionale dhe interpretimeve moderne të saj janë delikate, akoma edhe sot. Edhe pse ka ndryshuar shumë që nga shekulli i 20-të dhe jemi më afër se kurrë për arritjen e barazisë gjinore midis burrave dhe grave, ka çështje themelore dhe norma shoqërore që e pengojnë këtë realizim. Ne vazhdojmë të kemi besime shumë tradicionale në atë që është dukshëm “mashkullore” dhe “femërore”. Si rezultat, të dy burrat dhe gratë njësoj janë të detyruar të sfidojnë statusin për të ndjekur ëndrrat e tyre. Çdo gjë që bëjmë duhet të jetë në përputhje me normat shoqërore dhe nëse jo, ne jemi të stereotipizuar. Megjithatë, gjinia nuk përcakton një person.

Unë mendoj se frymëzimi për të gjithë duhet të mos jemi stereotip. Dhe më këtë dua të them të jesh atje për t'u përqëndruar në mbështetjen e barazisë gjinore. Në këtë mënyrë, veprimi ynë në shoqëri mund të jetë shumë me ngjyra dhe duke shpresuar që çdo ditë njerëzit të mos jenë të verbër nga ngjyrat .. Duke shpresuar që kjo temë mund të jetë simfonia më e ëmbël dhe të shpresojmë që njerëzit të mos jenë të shurdhët .. Në këtë mënyrë kjo fushatë mund të ketë melodinë më të ëmbël dhe ngjyrat më të ngrohta

Indira Kurti



Barazia gjinore në Shqipëri

Koncepti i barazisë gjinore, është tregues social me të cilin matet dhe zhvillohet vlerësimi i nivelit të emancipimit të shoqërisë shqiptare, qëndrimi i saj ndaj femrës dhe të saj në shoqëri.

Fillimisht dua të përmend se në shoqërinë në të cilën ne jetojmë burri vlerësohet më tepër se gruaja, ka më tepër autoritet se ajo. Por, a mendoni se është e drejtë të ndodhi kjo gjë? Në shoqëri tonë janë zhvilluar mjaft debate në lidhje me këtë aspekt dhe sigurisht ka patur mjaft polemika, pasi ne e dimë shumë mirë që kjo çështje nuk është kaq e thjeshtë. Madje mund të them e gjithë polemika e barzisë gjinore duket tepër shqetësuese dhe madje e bën femrën të diskriminuar, të ndihet e pabarabartë dhe shfaqet hapur inferioriteti.

Së dyti, duhet të përmend se barazia gjinore në vendin tonë po përballët me mjaft probleme të mëdha. Por, tek ky problem nuk qëndron vetëm dallimi burrë-grua por qëndrojnë dhe të drejtat njerëzore. Pikërisht, kjo është e gjithë “esenca njerëzore” që bën dhe duhet ti bejë gratë të zotërojnë plotësisht të drejtat siç i ka gjinia mashkullore në shoqërinë tonë. Duke patur parasysh që si meshkujt edhe femrat janë të afta të organizojnë, të drejtojnë organizata. Sot në vendin tonë femrat kanë bërë të mundur të fitojnë mjaft të drejta dhe të integrohen në jetën sociale, ekonomike, politike.

Por, mesa duket pavarësisht arritjeve të tyre ende vazhdon diskriminimi ndaj femrave. Ku diskriminimi ka arritur deri

në kulmin e tij dhe tashmë jemi prezentë në një farë mënyre duke dëgjuar në televizor apo nga interneti raste konkrete të ushtrimit të dhunës fizike, psikologjike ndaj gruas. Nga studimet e ndryshme, dhe nga statistikat e paraqitura në internet, shifrat e vrasjeve të grave janë bërë tepër shqetësuese.

Por, lind pyetja dhe sa do vazhdojë kjo situatë në vendin tonë? Perse, gruaja duhet të nënvlerësohet, të ndihet inferiore dhe mbi të gjitha duhet të ushtrohet dhunë mbi të. Mendoj se këto situata të ngjallin frikë, prandaj shoqëria njerëzore duhet të ndërgjegjësohet dhe mbi të gjitha të arrihet të vendoset një peshore me të dyja anët e barabarta.

Për ta mbyllur dua të theksoj se gruaja është njeri, është ajo qenie humane që sjell jetë dhe duhet të ketë vlera të barabarta në shoqëri, të respektohet në maksimumin e saj ashtu sikurse një mashkull kërkon respektin e tij por, jo vetëm kaq ... Ajo është e mençur, e brishtë, do vëmendje, përkushtim, dashuri, ngrohtësi dhe shumë të tjera. Barazia është e lindur dhe duhet të respektohet sepse, femra nuk është kurrë më pak se një mashkull, ajo është hyjnore dhe e tillë duhet të mbetet.

Irena Dula



Delikates

Si një lule e brishtë
Duket barazia gjinore
Mezi rri në këmbë
Pesha e viteve
Po e tremb

Një gjë e vogël
Trondit themelin
Të shkretët ne
S'dimë seç jemi
Vall a kemi shpirt?

Grisim drejtësinë
Dhe në fund duam veten
Të tjerët le të vuajnë
Nën të sotmen mizori
S'ka të drejta s'ka drejtësi...

Barazi zor se gjen
Sot nuk është e lehtë
Tirani sundon botën
Mashkull s'do mend
Është ky

Femra nga mbrapa
I vjen si bishtë
Po pse duhet ajo

Veten ta cënoj
Për çfarë ja vлека e gjitha kjo?

Themi ka barazi
Po veshtirë se e gjejmë
Duam lumturi
Por kështu nuk gjejmë
Varja kësaj bote ehhe s'ja vlen...

Shoqëria duket
Tek të drejtat e grave
Kur ato nuk janë
Për çfarë duhen fjalët
Ato teprojnë, teprojnë, teprojnë....

Jona Cenameri



Living with gender equality

Jetojmë në një shoqëri tipike patriarkale e cila ka ngulur rrënjë me kohë tek ne dhe që shumë vështirë mund ta zhdukim. Jetojmë në këtë botë ku mendoj se është përgjegjësia jonë e grave/vajzave, burrave/djemve sepse nëqoftëse duam që të rritemi në një ambient të shëndetshëm, ku t'i shikojmë familjarët tanë teksa bëjnë një jetë të mirëfilltë, të shikojmë gra/vajza që të mos dhunohen apo të konsiderohen "pro-na" nga vetë burri. Ne duhet t'i drejtojmë pyetjen vetes: Pse ndryshon ti nga unë? Ty burrë i dashur të vishesh me rroba të bukura, të pish kafe, të shëtisësh, por edhe une adhuroj të dal, të blej rroba. Pra i bie që të dy kemi dhunti. Por a ja vlen të luftojmë për një pozitë? Por a do të fitojmë në fund të fundit!

Në shoqërinë shqiptare me një orientim maskilist me një mentalitet akoma tradicional, kultura akoma e legjitimon pushtetin e burrave, vazhdon të prodhojë pabarazinë, diskriminimin me gjininë tjetër. Prania e këtyre faktorëve është një nga dëshmitë më të qarta që hasim, se pabarazia gjinore është prezente. Një ndër shkaqet mendoj që akoma e kemi këtë pabarazi është fakti që nëqoftëse e kemi vënë re nëpër konferencat, aktivitetet e ndryshme të organizuara për çështjet gjinore iu adresohen vetëm grave ose ose, rrallë ndodh që në këto aktivitete të marrin pjesë burrat ose të drejtohet nga vetë ata. Një tregues tjetër i pa(barazisë) është edhe për sa i përket statusit social. Disa nga analizat e bëra dëshmojnë se janë burrat ata që kanë arritur të ngrihen në hierarkinë statusore, duke zotëruar punë që janë shumë të

paguara, duke zotëruar poste në politikë, në botën e biznesit. Ky fakt dëshmon barrierat sociale dhe përpjekjet që duhet të bëjnë femrat për tu afirmuar në një shoqëri ku dominojnë meshkujt. Transformimi kulturor i shoqërisë është një proces shumë i gjatë dhe duhet të përmiresohet nga institucionet ligjore, ngritja e strukturave mbështetëse për krijimin e një shoqërie të barabartë në pune, karriere, perfaqësim, vendimarrje. Shoqëria jonë duhet të bëjë një rrugë mjaft të gjatë, ku barazia gjinore të jetë pranuar, ku sikur burrat edhe gratë të kenë të njëjtat privilegje, të njëjtat pjesëmarrje në sferat e jetës shoqërore. Ama une di diçka dhe më bën të besoj që ne jemi mjaft të forta për të depërtuar kudo me vullnetin për të bërë më të mirën.

Femra nuk ka nevojë për diçka që t'ia dalë, as nuk duhet të jetë skllavja e dikujt për ndere, sepse unë besoj se është e zonja për t'ia dalë. Ne duhet të mendojmë diçka të gjithë së bashku në të mirë të shoqërisë. Kauzën për barazi gjinore, e cila është kauzë e të gjithëve. Për një shoqëri më të emancipuar, jo një shoqëri të dhunuar, të shtrembëruar nga maskilizmi, me të drejta të barabarta, paragjykimet duhet të hidhen poshtë dhe çdo kush të gëzojë privilegjet e tij pavarësisht nga gjinia. Ndërgjegjësohuni sepse vajzat/gratë janë të afta të shpalosin vetëm vlera dhe profesionalizëm. Gratë janë të forta, jepu mundësinë për një jetë më të mirë!


Klaudia Ndoci

Dora që peshon njësoj

Më fshij lotët që më bien,
Me të njëjtën pëllëmbë që më bie supeve,
Më jep një shtysë që me zë t'bërtas,
Mos më thuaj ul kryet se je vajzë..
Më përqafo,
Dhe atëherë kur nuk e dua as vetveten,
Veç atëher kam më tepër nevojë...
Më mbeshitet, zërin të ngre,
Të mos kem frikë se do dështoj..
Të mos kem frikë nga brishtësia,
Të ndjej dhe unë peshën e eshtrave te mija..
Të jem dhe une diçka si ti,
Femër..
Në atë peshore të ndjej barazi..
Mos ec rrugëve të këtij qyteti,
Mos ec natën vonë ngrehinave të tij,
Qetë me zërin se je vajzë,
Marre të të vijë, hesht, ul kryet ,rri..
Femër për shtëpi,
Femër për fëmijë,
Objekt riprodhimi..
Marionetë e tij..
Më puth lotin që më bie,
Jam me ty, me përshpërit...
Une dola prej tëndes brinjë...
jam dhe unë siluetë e tëndit pasqyrim .
Grushti jot s'peshon njësoj,

Mbylle gojën se je “zoj”
Mos fol se je femër..
Mendjelehtë që mendon me zemër,
Plagë e vjetër është mjerimi,
Por skamjen e shpirtit tënd a e ke parë?
Ti je më shumë se unë, për cfarë?
Je perëndi se je djalë??
Hija jote peshon më tepër se unë,
Thuaj?
Tek ngërdheshja portretizon arrogancën që shfren..
Seks i dobët
Paragjykon mua..
Një frymor, i vdekshëm që superioritetin nën frymë ti zjen..
Më përqafo,
Më fal ngrohtësi...
Më thuaj kjo dorë peshon njësoj...
Të ndihem dhe unë si ti...
Dora që tund djepin është dorë që botën sundon.

Lorenca Bejko



PA DISKRIMINIM!

Çfarë është brishtësia për ty?
A tregon ajo pikën tënde më të fortë?
Të kesh brishtësi në ditët e sotme është virty
Njerëzia po rend mbas kryeneçësisë së kotë

Përse të jemi njëlloj kur jemi krijuar për të qenë të ndryshëm
Dhe në atë shumëllojshmëri njëri tjetrin të respektojmë
Çfarë të kushton të jesh i mirëkuptueshëm
Dhe femrën të mos e diskriminojmë

Zoti krijoi dy gjinitë në barazi
Zbathur e zhveshur me të njëjtat kushte e rehati
Dhe pse karakteristika të ndryshme i dha
Në pozita të njëjta ai i la

Femra duhet dashuruar e jo diskriminuar
E ndër vite diskriminimi sërish ka vazhduar
Ky Fenomen aspak i këndshëm
Sa më shpejt duhet parandaluar

Femër apo mashkull qofsh
I bekuar nga zoti zbret në tokë me një mision e qëllim
Përpiqu sa më herët ti ta zbulosh
Përmbush misionin e jeto jetën PA DISKRIMINIM!

Megi Zani



Të jetosh me barazinë gjinore

I dashur lexues,

Do doja të ndaja diçka me ty. Ti nuk më njeh dhe ndoshta as nuk është në interesat e tua ky shqetësim i imi, por ka kohë që dua të shprehem. Nuk mendoj se e dëgjon shpesh këtë ç'ka do të të them, por dua të flas pak për barazinë midis djemve dhe vajzave. E di, jo të gjithë kanë kohën, kurajon apo dhe dëshirën për të folur për këtë, por dita ditës reflektoj pak dhe e kuptoj më thellë.

“Barazia gjinore” ndoshta është fjala më e përdorur në ditët e sotme. Ndoshta sepse shumë të rinj ndihen më pranë shoqërisë së avancuar duke e përdorur këtë fjalë më shpesh. Ndoshta edhe sepse vetë shoqëria mund të duket sikur ushtron presion për të rinjtë për të qenë më të ndërgjegjshëm ose ndoshta thjesht kjo shoqëri mundohet të bëjë atë që nuk u bë dot që në fillim të saj.

Jam e bindur që nëse do të pyes dikë tani se ç'do të thotë “barazi gjinore” do të më përgjigjet me një frazë të rëndomtë të tipit “Thjesht meshkujt dhe femrat të jenë të barabartë”. Tingëllon e saktë, por nuk është aspak e plotë.

Të kesh barazi gjinore është më shumë se kaq dhe të jetosh me barazinë gjinore është akoma dhe më shumë. Të jesh i barabartë nuk do të thotë vetëm të vihet figura e mashkullit dhe e femrës në të njëjtin nivel, por të mendohet dhe të njihet si e tillë. Ne njohim konceptin, por nuk njohim ekzistencën e saj.

Si ka mundesi që nëse pyes një bashkëmoshataren time se ç'do të thotë barazi gjinore ajo është më e qartë dhe e sigurt se sa një bashkëmoshatar i imi? Nuk mendoj më se është shoqëria patriarkale që nuk i lejon meshkujt ta njohin konceptin e barazisë. Qytetërimi ynë e ka hedhur poshtë këtë, por është vetë edukata që marrin meshkujt e rinj dhe që e transmetojnë më pas dhe të bijtë e tyre.

Lexus i dashur, unë nuk jam shkencëtare dhe as nuk nxjerr statistika, por fakti qëndron që në shtetin tim, në mes të kryeqytetit ekziston akoma mentaliteti i vjetër, ku mashkulli shihet si e vetmja

figurë potente, që mund të mbajë çdo gjë, ndërkohë që femrat nënvlerësohen për aftësitë që kanë. Diçka që më jep shpresë është që këta njerëz sa vijnë dhe pakësohen. Me kalimin e kohës shoqëria ndryshon, kthjellohet dhe figurat njerëzore shkojnë në ekuilibër dhe në nivelin e duhur.

Barazia gjinore nuk ka arritur akoma aty ku duhet. Shihen akoma femra të nëpërkëmbura dhe meshkuj që i nëpërkëmbin ato. Për sa kohë të jetojë mendimi se femra është në një post më të ulët dhe mashkulli me një kapacitet më të madh se femra, atëherë s'mund të pretendoj për barazi gjinore. Për sa kohë të mos vritet ideja se një femër nuk mund të dalë e vetme, të shihet si pronë, si pre dhe si një objekt, nuk ka për të çelur jeta në barazi.

Ama besoj se kjo jetë ka për t'u shfaqur. Meshkujt edukohen, femrat rriten. Të gjithë bëhemi burra. Mund të lind pyetja pse pikërisht “burra”? Mendoj se nuk bëhet fjalë për gjininë, por bëhet fjalë për forcën. Se si rritemi, se si zhvillohemi, se si ne formojmë karakterin potent, qofshim djem apo vajza. Asnjëra gjini nuk po mësohet të jetë inferiore dhe as superiore. Secila po mësohet të jetojë në harmoni me njëra tjetrën.

Ndoshta pas një shekulli, kur lëvizjet e barazisë gjinore të lexohen nëpër libra, do të duket çmenduri se ka ekzistuar vërtet ky problem. Ndoshta do të jetë akoma dhe më herët se një shekull që gjithçka të ndryshojë. Ndoshta do të jemi ne, pikërisht unë që shkruaj, ajo që do të bëjë ndryshimin, sado i vogël të jetë ai.

Shpresoj ta kesh kuptuar atë çfarë kam dashur të them. Nuk të premtoj se do të ndodhë si me magji dhe as nuk të kërkoj të më përgjigjesh. Thjesht dua ta kuptosh, pasi kjo është e vetmja gjë që kërkohet nga të gjithë.

Me përzemërsi , Odri Lako

Barazia gjinore,ende një çështje për t'u diskutuar

Barazia gjinore mund të duket si një temë klishe, si një çështje tashmë e ezauruar dhe ndoshta shumëkush mund të pyesë nëse ende ka diçka për të diskutuar rreth saj, në shekullin e XXI? E vërtetë,mund të jetë një çështje shumë e diskutuar,por interesimi për të,ndërgjesimi për të ka qenë i përciptë nga të dyja palët. Në këtë gjendje, mund të duket sikur jemi ende në periudhën e manifesteve të para për të drejtat e njeriut sepse pavarësisht zhvillimeve të mëdha teknologjike,njerëzit po t'i zhveshësh nga dukja,në thelb mbeten po të njëjtët. Edhe stereotipet mbeten po të njëjtat. Fillimisht, përgjatë këtij shkrimi duhen sqaruar disa koncepte. Duhet ditur se çfarë është gjinia.

Ndryshe nga seksi që është një ndarje biologjike, natyrore, gjinia është një ndarje e bazuar në qasjen, sjelljen, rolin që pret shoqëria nga individit.Gjinia është e mësuar nga vetë njerëzit por edhe që mund të ndryshojë. Stereotipet fiksojnë modelin e të qenit burrë dhe modelin e të qenurit grua, ndarjen e roleve dhe kontributin social.

Ndarja e roleve, e sferave të veprimit nis qysh femijë, si pasojë edhe kufizimi i mendimit, i lirisë, i mundësive nis me fëmijërinë.Ky kufizim ngjason me kufizimet i ri ose jo, i bardhë ose jo, që shërbejnë vetëm për të asimiluar para kohe potencialet e tyre. Ne si individë nuk krijohe mi në vakum, vetëbesimi dhe vetëvlerësimi që kemi për veten është efekt i influencës sociale. Edhe marrëdhënia jonë me tjetrin është pasojë e mjedisit përreth. Edhe deri me sot, marrëdhënia burrë-grua ose statusi midis dy gjinive ka qenë i ngjashëm me marrëdhënien at-bir, skllav-pronar. Gratë kanë mësuar të kenë frikë nga liria, nga vendimmarrja, nga vetmia. Gru-

aja mëson vetëm të respektojë të tjerët, por sa mund të respektosh të tjerët, kur nuk njeh dhe nuk respekton veten?!

Kur mund të arrihet barazia gjinore?


Barazia gjinore arrihet kur të dyja gjinitë gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi në të gjithë sektorët e shoqërisë.Atëherë kur nevojat e grave dhe burrave vlerësohen njësoj. Barazia gjinore, rëndomtë pretendohet se lidhet me ndryshimin e rolit të gruas në shoqëri.

Por, ndryshimet në rolin e gruas në shoqëri, kërkojnë ndryshime edhe në rolin e burrit. Ndoshta një ditë,në të ardhmen nuk do flasim për ndarjen e sferës së gjinisë femërore dhe asaj të gjinisë mashkullore.

Përse barazia gjinore është në dobi edhe të gjinisë mashkullore?

Duket sikur barazia gjinore është një kauzë që i përket dhe i drejtohet vetëm gjinisë femërore, por në fakt barazia gjinore nuk është një kauzë në përfitim të gjinisë femërore, as në përfitim të asaj mashkullore, por në përfitim të shoqërisë, të njerëzimit. Njerëzimi është më i rëndësishëm se ndarjet gjinore. Kjo kauzë është në favor të zhvillimit të shoqërisë, rrjedhimisht edhe zhvillimit individual, që vjen si rezultat i asimilimit të hierarkisë, heqjes së barrierave në shoqëri dhe njohjes me tjetrin. Barazia gjinore,mund të shihet edhe si një dialektikë e shpirtit, jo më si një dialektikë mes mjeshtrit dhe dishepullit,por si një argumentim, si një arsyetim mes dy qenieve të barabarta, dy qenieve në kërkim të së vërtetës.

Oriada Dajko



Ky mëngjes...më fal trishtim,
teksa ndjej thellë shpirtin tim
se si qan e n'heshtje vuan
kur dhe ëndrrat nuk e duan...!
E largojnë shpirtin e mjerë,
sepse ëndrrat s'patën ndjerë
sa qetësisht i mbaja n'zemër
përplot frikë...se isha femër.
Unë luftoja pa bërë zhurmë,
me gjithë botën në një turmë
sa heë flisnin,kuvendonin.
Sa si unë nuk e gëzonin jetën?
E më tej t' vërtetën?!
Flet djali e hesht femra,
dëgjon zërin e rreh zemra
me shumë frikë...pasiguri,
dhe ja bindet përsëri.
Si robot, kaq e pajetë
ka harruar edhe vetë
se e fortë ishte dikur
...para fshehjes n'atë mur,
kur dhe zemra s'kish qenë gurë.
Ai mëngjes...trishtim më fali,
se dhe kohën dot se ndali,

e unë ndjeva nostalgji,
për kur isha thjesht femijë.
Lehtë vrapoja me liri...
sepse ndjeja lumturi.
Po ku fshihet vallë tani
kam shumë kohë që nuk e di
... a do të kthehet përsëri?
Të drejtohem ty trishtim,
thjesht dëgjoje zërin tim..
sa e ndjen keqtrajtimin
teksa shuan lehtë gëzimin.
Sa e njeh ti një liri
kur rri mbyllur në shtëpi?
Sa të dhemb ty një shuplakë
në një lot që të djeg flakë?
Vec më thuaj dhe njëherë,
ti trishtim...a më ke ndjerë
kur të flisja s'munda dot
se më mundi ajo botë,
për një forcë edhe një emër
fare vetëm...se jam femër!

Sara Ismaili

Të jetosh me barazinë gjinore

Përsëritet unë jam një vajzë 17 vjeçare e cila ka një baba, një vëlla, një mësues ka miq djem dhe ka as më shumë e as me pak se sa një mashkull. Si unë duhet të jetë dhe çdo femër tjetër kudo qoftë.

Në qoftë se do të lexojmë një përkufizim për mashkullin dhe një për femrën do të lexojmë që pikë së pari të dy jemi qenie humane dhe kemi ndryshime të vogla por që nuk janë për të na diferencuar njëri nga tjetri por për të na bërë me unik në atë që në jemi.

Të jetosh me barazinë gjinore më shumë se sa një qëllim ngjan me një ëndërr sepse asnjëherë nuk kemi patur një barazi gjinore dhe prej miliona vitesh që me krijimin e botës kemi një nënrenditje të femrës në piramidën e pushtetit në vend që femra të ishte në ekuilibër me mashkullin në peshoren e pushtetit.

Duke pasur një fenomen të tillë pra nënvlersimin dhe shtypjen e femrës prej më shumë kohesh seç mund të thuhet është e vështirë të ndryshohet dhe të arrihet barazia absolute por ne nuk mund të rrimë dhe të mos bëjmë asgjë në lidhje me këtë vetëm sepse jemi ne të barabartë në ambientin ku ne jetojme apo vetëm se i jemi nënshtruar pabarazisë.

Meshkujt duhet të kuptojnë se në qoftë se ata e shohin ose konsiderojnë veten të barabartë me një femër ata nuk poshtërojnë veten apo nderin e tyre mashkullor por në të kundërt ata vetëm sa u shtojnë vlera vetes së tyre. Një femër e cila ngre zerin dhe lufton për të qenë e barabartë duke e pare veten të barabartë me një mashkull nuk është rebele apo e çmendur ajo është thjesht një femer e cila e di vlerën e saj dhe është e gatshme të mbrojë të drejtat e saj dhe kështu duhet të bëjë çdo femër, duhet të thyejë tabutë e shoqërisë dhe ti dalë për zot vetes.

Shumë njerëz ndoshta nuk e shohin këtë një problem pasi për shkak të klimës ekonomike apo problematikave shëndetësore nëpër botë mund të themi se ky nuk mund të quhet as një problem por


thjesht një kapriço ama jo. Ky është një problem që po ndrydh rreth 50% të popullsisë në botë duke ndikur në mirëqenien e tyre jo vetëm mendore e shpirtërore por edhe në shëndetin e tyre nga ana fizike dhe në jetën e tyre sociale ekonomike.

Zgjidhja nuk janë as meshkujt as femrat por zgjidhja e vërtetë jemi të dy sëbashku. Po, jemi dhe meshkujt dhe femrat zgjidhja ose me saktë puna jonë e përbashkët për një kontribut pozitiv. Them të dy sëbashku sepse një mashkull i cili i jep barazi një femre e cila nuk mendon se është e aftë për atë barazi ose se nuk e meriton do ishte e kotë dhe një femër e cila lufton për barazi me meshkujt të cilët janë mendjembyllur dhe fjalën barazi nuk e njohin atëhere prapë është e kotë.

Fatmirësisht ndryshimi ka nisur pasi në ditët e sotme në zonat e zhvilluara urbane barazia në vija të përgjithshme ekziston. Kemi meshkuj madje dhe djem të rinj që janë sensibilizuar dhe janë pro barazisë e merren me aktivitete duke e promovuar këtë ideal dhe kemi dhe femra që kanë arritur kaq shumë e janë në maja sepse kanë patur besim te vetja dhe nuk lejojnë që pabarazia gjinore të ndodhë. Ama duhet të kemi një rritje në numër të këtyre personave, duhet që mendjet e njerëzve të hapen dhe të kuptojnë që kjo është e domosdoshme.

Të jetosh me barazinë gjinore do të thotë të jetosh i lirë dhe të kuptosh që nuk ka një rol sipër teje apo se roli jot është sipër tjetrit por ka një rol vetëm krah teje!

Sara Kucuku



"Living With Gender Equality"

Unë linda në një të enjte Maji, ime më ka treguar se ishte një mesditë me diell. Më pritën në maternitetin e Pukës, pa shumë zhurmë me kujdesin dhe merakun e dy gjysheve të mija. Im atë, atë nëntë Maj rastisi të mos ishte në shtëpi, kishte shkuar në një miting me autobuza në Tiranë, bashkë me të një kope burrash, siç i cilësonte nënoja, pasi ishte prag i zgjedhjeve të 1996-s të cilat do mbaheshin pas disa ditësh.

Kur u kthye në darkë dhe i thanë se ishte bërë me vajzë, im atë në fillim ishte mekur e pastaj ishte nxehur e kishte thënë ngadalë : "E paska kënaqur! Lëreni në spital, e gruaja të vijë në shtëpi!"

Pasi i kishin rënë nervat, më në fund, me gjithë ngazëllimin e rezulttit të zgjedhjeve, ai kishte ndarë mendjen të na merrte nga materniteti, dy javë më vonë. "Merreni, të rrijë të hajë dhe ajo një copë bukë" e kishte inkurajuar babai i madh. Me këtë historinë e nëntë majit u rrita, kush e di sa e sa herë kisha dëgjuar babanë t'ja thoshte me shumë krenari vella tim të vogël se më kishin lënë dy javë në maternitet, e me këtë gajaseshin të dy. Kurse unë çdo herë përpiqesha të gjeja cila ishte pjesa për të qeshur në këtë histori, nga e cila s'di pse ndjeja dhe turp.

Unë linda në nëntë maj si femija i parë në një familje me nam të mirë në qytet, po për mua nuk kishin shtënë me pushkën e gjuetisë së gjyshit, siç gëzuan dy vjet më vonë për tim vëlla. Nëna e kishte peng që nuk e kishin dëgjuar të më bënin një drekë emri.

Për sa mbaj mend, gjithmonë, e kam kam gjetur veten duke menduar pse nuk i sillja dot gëzim dhe krenari meshkujve të shtëpisë sime. Unë isha e qartë për menyren e të menduarit në familjen time, edhe pse me kohën kuptova se nuk kishte një llogjike, dukej se gjyshja, mamaja ime e jo vetem e kishin pranuar dhe mendonin se nëse bëhej ndryshe rrezikohemi nga imoraliteti, kështu e kështu u desh ta pranoja dhe unë. Kisha kuptuar se forma e të menduarit të tim eti nuk ishte asgjë vecse reflektim i sjelljes dhe mendimit të lagjes, të qytetit, të të gjithë shoqërisë. Në një shoqëri ku njerëzit shprehin mëshirë për tezen time kur i thotë se kishte tre vajza, një shoqëri ku time më e ngushëllojnë sa herë që tregonte me naivitetet se vajza e saj, pra unë, jam ende e pa martuar edhe pse vetëm njëzet e një vjeç, aty ku të gjithë të urojnë "U bëfsh me një djalë" a thua se po t'ja dilësh të riprodhoje një mashkull ka vlera më

të medha se te të lindësh një vajzë. Pra ishte një sistem mendimi shumë më i gjerë se familja ime, ku unë isha e qartë se edhe sikur të isha njeriu më ideal në botë, serish mbetesha vetëm një vajzë!

Mesuesja ime e nëntë vjeçares, një grua shkodrane që kish qënë e përsëkutuara politike, më sillte libra, më nxiste t'i lexoja duke më thënë se mbase kështu do mund të kuptoja dhe të dija si të silllesha me meshkujt e tjerë që jeta do më përballte. Edhe pse e ndjeja skepticizëm e saj për rezultatet që mund të arrinte, ajo vazhonte të këmgulte se mund t'ja dilnim të thyenim mungesën e vëlbësimit që ishte mbjellë tek unë. Më ishte tiposur në mendje zëri i saj i plotë kur me bindje më thoshte se "mbase s'do mundemi asnjëherë të ndryshojmë mënyrën se si na shohin të tjerët, po ka shumë rëndësi të paktën t'ja dalim të shohim veten si duhet".

Sot jam njëzet e një vjeç, i mbusha në nëntë maj dhe mesuesen e nëntëvjeçares se kam takuar më prej kohës, po ajo jeton në mua! Jeton me mua kur unë qesh me vete se e di se sa naiv tregohet babai im, kur krenohet për faktin që unë nuk flas dhe nuk them mendimin tim, pasi kështu njerëzit e përgëzojnë se ka një vajzë të urtë. Është me mua kur dua të shkund gjyshen time tetëdhjetë e një vjeçare që më thotë "Mëso të gatuash të keqen nëna se nesër pasnesër do shkosh t'i shërbesh burrit". Është me mua kur unë marr guximin t'i sqaroj tim vëllai që i kemi të dy njësoj duart funksionale për të bërë punët tona, kështu që nuk ka pse të presë nga femrat e shtëpisë që t'i shërbejnë.

Mësuesja ime e nëntë vjeçares është me mua kur unë shoh veten në pasqyrë dhe jam krenare për revolucionin tim të vogël në raport me shoqërinë, po nuk di në ka revolucion më të madh se ai i mendjes time, të rrethuar nga njëmijë shembuj negativë që zhurmojnë rreth saj.

Unë e di se sot duhet të jem krenare për veten, e jo se jam vajzë, po se e di që ska asnjë lloj rëndësie se çfarë gjinie ka personi që kam përballë, po ka rëndësi çfarë thotë, mendon, ëndërron e si vepron!

Valbona Bezati



Barazia gjinore është një hap shumë i rëndësishëm për frymëmarrjen e familjes, shoqërisë si dhe për integrimin e një vendi në BE. Ajo nuk është thjesht një objektiv politik por një parim social, për të bërë të mundur bashkëjetesën e individëve në harmoni dhe paqe. Barazia gjinore i jep mundësinë si femrës dhe mashkullit të kenë akses në të gjitha aspektet e jetës, ndërkohë institucionet nga ana tjetër bëjnë të mundur zbatimin material të ligjit dhe garantimin e tij. Por si është barazia gjinore në Shqipëri?

Të flasësh për barazinë gjinore në Shqipëri është si të kërkes diellin në Antarktidë...Pak ironike apo jo? E drejtë, sepse i tillë ka qenë e fati i femrës në këtë shoqëri. Mjafton të hapësh televizionin, gazetatat dhe shumë shpejt e kupton përgjigjen. Vrasjet janë ato “përgjigje” që të lenë pa përgjigje...Format e tyre janë nga më të larmishmet, fillojnë që nga përdorimi i litarit, sëpatave, thikës, e deri te armët bashkëkohore”...Pra krimi në familje, në larminë e formave është përgjigjja më e mirë e “ ekzistencës së barazisë gjinore” në Shqipëri.

Jo vetëm që nuk ka barazi por ka kaq shumë mosbarazi sa të bejnë të mendosh e vesh në dyshim “ botën dhe kohën në të cilën jetojmë...Ndonjëherë më duket sikur kemi ngecur në kohë si shoqëri dhe s’po dalim dot nga kjo vorbull, nga kjo amulli...Hedh vështrimin kudo ku ka meshkuj dhe mendoj a e meriton kjo shoqëri maskiliste femrën???

Ej ti që e quan veten burrë, a mund t’i heqësh për një çast “mus-taqet” dhe të mendosh se kush të solli në këtë jetë, kush e tundi djepin, të dha qumësht e të rriti?

Po ti djalë aty që shan dhe fyen ...mund të më thuash pak se kush të qëndron pas, sa here ti kërkon ushqim, larje ,hekurose, kush ku-

jdeset për ty sa here që mamaja vjen e lodhur në shtëpi? Kush të mbron, këshillon, e bëhet supi yt sa herë lotët e tu të fshehtë tentojnë të arratisen fshehurazi? ...Ndalu pak e mendo para se grushtat e tu të godasin atë supin në të cilin dje qave ,krahët që të mbajtën kur ti rrezoheshe...Ndale pak ritmin e arrogancës, vlerin...AJO që ti i bertet ,godet,vret eshte motra jote.Kujdes me fjalën, sepse veshët e saj janë ata që dje kanë dëgjuar dhimbjen tënde , sytë e saj që ti sot s’i kthen kokën janë ata që shihnin çdo lot tëndin, janë sytë e nje qenieje që të ndjekin kudo...e atëhere kur bota humbet fillin... Zemra e saj është vullkan dhe është e gatshme të sfidojë e akullnajat më të mëdha të botës ,por mos u bëj ti...

Jeta është e shkurtër dhe e vështirë mik por femra do ta bëjë të gjatë mjaftueshëm me forcë dhe gëzim, prandaj mos luaj me të....sepse kudo të shkosh e në fund të botës nuk ka për të bërë zotëri ajo gravata që ti mban, por edukata, sjellja. Nëse nuk e njeh dhe vjen nga një e shkuar e familje patriarkale, çohu, mëso, të dish nuk është e tepërt, përkundrazi kultura të zbukuron jetën. Mëso ti vendosësh kurorë një femre, në vend të këpucëve, e nata do zhduket sepse ajo që ti dikur e bëje baltë thellë brenda saj rrezaton një dritë që nëse e sheh kupton se është gjëja me e çmuar që ti ke.

Nëse ti nuk ke sy për ta parë,veshë për ta dëgjuar,dil e shiko përtej hundës sate zotëri.

Duhet te dalim nga kjo amulli. Përpara kemi EUROPEEN që na thërret drejt bashkimit, pas padronët e paragjykit. Dhe ne si shoqëri vazhdojmë endemi në këtë rrugë , në mesin e një litari që herë tërheq njëra e herë tjetra. Kështu, e shkuara përserit vetveten duke riprodhuar të njëjtat patologji të sjelljes duke vlarë ëndrra, por e jetë femrash. E ardhmja dërgon mesazhe e sinjale drite drejt

emancipimit. Duket sikur Europa tenton herë pas herë të na shpëtoje, nga gjumi i injorancës, gjumi i vdekjes. QEVERIA SHQIPTARE dëgjon, institucioni ligjvënës harton e përmirëson ligje, ndizet drita jeshile por aty jashtë parlamentit, kushtetutës kembanat e dhunës bien sërish. Shumë femra paragjykohe, mjafton të ndalim vështrimin tek eksperiencia e njerëzve që na rrethojnë, diku te mjedisi familiar, diku farefisnor e diku shoqëror. Ja disa prej tyre Në aspektin e kulturës : Ka ende familje në të cilat talenti në muzikë, aktrim apo kërcim nuk zhvillohet vetëm se ajo që e posedon këtë dhunti është femër. Pra kemi të bëjmë me një vrasje” ëndrrash” vetëm se shihet në kuptimin e ngushtë të një mentaliteti paragjykses.

Në aspektin e punësimit. Këtu kemi evoluar por ka ende punë të tilla si puna e kamarierit, që ende shihen si e drejtë e meshkujve për të zgjedhur dhe jo e femrave.


Në aspektin e të drejtës së martesës. Shumë vajza ende pa mbushur 18 vjeç fejohe e martohen pa dhënë ende vulën e tyre, duke dhunuar kështu lirinë që prodhon më vonë konflikte të vazhdueshme e bën që pakënaqësia të shpërthejë në dhunë. Kemi të bëjmë me dy forma të dhunës që pasojnë njëra tjetrën : dhuna psikologjike dhe më pas dhuna fizike.

Në aspektin juridik e qytetar. E drejta e divorcit. Ekziston të paktën një çift që ndahet në çdo rreth farefisnor të një individi dhe minimalisht një baba që nuk jep firmën e divorcit, është gjithmonë një femër që sorollatet gjykatave për një firmë që ti japë asaj lirinë dhe

fëmijës së vet atësinë. Pasojat juridike nuk bien vetëm mbi nënën por e fëmijën, duke e lënë pa baba atë si dhe duke i kufizuar dhe lirinë e lëvizjes.

Këto pra janë vetëm disa nga aspektet e paragjykimit dhe format e dhunimit të femrës që tregojnë se barazia gjinore është më tepër teorike dhe shumë pak e realizuar dhe për këtë arsye janë tek paradokset që ne si shoqëri jemi ushqyer më shumë se politika, faji gjendet tek prejardhja nga një familje patriarkale. mbetet më shumë për të bërë nga OJF e vetë shoqëria, edukime, trajnime dhe barazia nis që në edukim në lindje. PËR SA KOHË SA NE SI SHOQËRI NUK DUAM TË DËGJOJMË E SHOHIM MË TUTJE, E NE SI FEMRA NUK PËRMBUSHIM VLERAT DHE IMAZHIN TONË, DO VAZHDOJNË SËRISH KËMBANAT E DHUNËS....

Zhilberta Dine





Situata aktuale e barazisë gjinore në Shqipëri.

Po mendoja për ty , vajzë e dashur ! Që linde ne Shqipëri , aty ku emri të është menduar që në barkun e nënës , dhe bashkë me emrin edhe jeta që duhet të jetosh ! Aty ku , fjala 'djalë' dhe 'vajzë' nuk ndryshojnë vetëm nga gjinia , por nga mentaliteti kulturor! Aty ku dyqanet janë të ndara , po ashtu dhe ngjyra blu për djemtë dhe rozë për vajzat! Sigurisht , kukulla Barbi 'rritet' me një vajzë ,dhe pistoletat është një lodër për djem. Kështu veprojnë prindërit Shqiptar. U mësojnë vajzave të jenë të brishta dhe të urta , dhe sigurisht që djemve u mësohet se duhet të jenë të fortë dhe të pushtetshëm !

Po mendoja për ty , vajzë e vogël që u rrite ! U bërë një adoleshente ! Por , ti normalisht duhet të qëndrosh në shtëpi , për nderin e familjes! Sepse , sipas familjes tënde nderi yt dhe i prindërve vjen nga të qëndruarit në shtëpi. Epo , te lutem shumë, një adoleshent djalë duhet të dalë sa më shumë , sepse bëhet më i zoti i vetes! Ah , normalisht që një vajzë shtëpie duhet të meçojë të gatujë dhe të bëjë punët e shtëpisë , sepse më vonë do martohet , por një djalë nuk ka pse t'i mësojë këto , madje shumicën e gjërave duhet t'a keqë gati.

Po mendoja për ty , adoleshente e dashur që u rrite ! U bërë një femër ! Tani realisht u rrite për të tjerët , u bërë për t'u martuar ! Pse ske gjetur një burrë që të martohesh ? Cfarë , nuk e do një gjë të tillë ?? Dëshiron të dalësh jashtë zakonit ? Dëshiron të ndjekësh ëndrrat e tua , të ndjekësh karrierën tënde , të jesh dikush me vlerë , e suksesshme ?? MOS , sapo u fute në një rrugë ndryshe ! Aty ku ka vetëm fjalë , paragjykime , stereotipe dhe e fundit por jo nga rëndësia , thashetheme! Por ,më vjen keq të të them se je më pak e privilegjuar sesa një mashkull. Ai do ta ketë më të thjeshtë të shkoje në krye të rrugës që ti ke zgjedhur , sepse kultura jonë nuk e paragjykon një mashkull.

Po mendoja për ty , femër e dashur , që u bërë një grua ! Tanimë , një nënë ! Epo , tani do duhet të rrih në shtëpi ! Është burri ai

që sjell të ardhura financiare brenda shtëpisë. Detyra jote është të kujdesesh për fëmijët dhe të bësh punë 'angari' brenda mureve të shtëpisë. Ah , harrova të të pyes ! Ke gatuar sot ? I ke larë rrobat ? A ia ke hekurosur burrit atë këmishën që i duhet për nesër ? Sepse ai i shkreti vjen i lodhur sepse ka qënë në punë ndërsa ti ke qënë gjithë ditën në shtëpi , që sipas njerëzve ke ndenjur 'kot'. Cfarë ? Ti dëshiron të punosh që punë të paguar jashtë shtëpisë ? Që të kesh më shumë të ardhura financiare për të gjithë familjen ? Që edhe vetë të kuptosh që je njëri që vlen mbi gjithcka ? Hmm , mendoje mirë para se të dalësh nga dera sepse Big Brother te vëzhgon ! Tani po mendoj për ty , Shqipëri e dashur ! Je si një shëgë e bukur nga jashtë , dhe me shumë kokrra te vogla brenda , që jemi vetë ne njerëzit e tu. Janë kokrrat e shëgës që e bëjnë atë të jetë e shijshme ose jo. Dhe jemi ne , njerëzit e tu , Shqipëri e dashur , që vendosim për gjithcka! Jetojmë në një vend si ty , ku grupi emëror ' barazi gjinore ' akoma nuk ekziston ! Por diferencimi gjinor është akoma rregull në fuqi. Epo , të lutem shumë ! Pse një mashkull quhet më autoritar dhe më mashkullor kur mund të krijojë disa lidhje dashurore ndërsa një femër jo sepse merr pseudonime nga më të ndryshmet ? Pse një mashkull ka me shume liri zgjedhjeje dhe një femer jo ? Pse një mashkull e ka me te thjeshte te gjejë një vend pune , ndërsa një femer , eh , duhet mundësisht të jetë Angelina Jolie që të fillojë një punë që në intervistën e parë? Pse një mashkull mund të flasë në cdolloj mënyre që dëshiron , ndërsa për një femër qënka dicka e jashtëzakonshme ? Epra , të gjitha këto tregojnë situatën aktuale ne Shqipëri . Normalisht , shumë gjëra janë zhvilluar , shumica e njerëzve janë emancipuar dhe sensibilizimi po përmirësohet . Por , gjithsesi , mbetet akoma shume punë për të bërë , për të arritur aty ku duhet , barazi gjinore ne Shqipërinë tonë të dashur !

Armela Memaçi

Botëthyer...

Femrës ia kanë vjedhur kutinë e Pandorës,
Ia kanë zbrazur në shpirt!
Mashkull që vret, ther, rreh,
Miresinë që puth, përqafo, përkedhel!
Femër e mirë, e përbuzur nga pranga mentalitetesh
Medjeprishurish, që ti refuzon ti dëgjosh
Kryenece, e pazbutur, pikturon jetën tënde,
Por...
Ne telajot e natës, boja e ditës është njollsur
Kur lotët binin me teprinë e erës,
Kur gjunjëzohesh se nuk mundesh më,
Por...
Ai, ai yt shoq pinte birra e shihte ndeshje...
Ti qaje e pikturoje në telajo për të ndrequr,
Për të ndrequr
Për të ndrequr gabimet e kësaj bote,
Gabimet e kësaj bote idiote,
E cila, e cila është kaq e mjerë, kaq absurde, kaq nonsens
Botë e ndyrë pa gjak
E cila ngre në panteone e pidestale
Duke vlerësuar e gjykuar nga organet gjenitale...
Botë qelbesirë,
Harron kush jep jetën, dhe kush na e merr atë,
Burrë me penis, por pa burrëri, pa besnikëri.
Që i merr punën, nderin, botën, shpirtin e jetën një krijese,
Si femra...
Botë që nuk vlerëson heshtjen,
Heshtjen dhe vdekjen, punën dhe jetën,
Femrën, të mirën e gjithçkasë.
Mjaft!
Kjo duhet të marrë fund.
Fund...
Njëherë e mirë, pabarazi gjinore? Eshhtë mëkat!
Femra brilantesë-krijesë e natyrës,
Duhet të ngrihet, të ngrihet si feniks, e të fluturojë mbi qiej,
Mbi qiej të braktisur, për të marrë hakun që i ka falur qielli.

Pabarazia gjinore vret natën kur hëna kërcen në lumin e jetës,
E qiella kërcëllet dhëmbët,
E shiu nis se qiella mori në gji edhe një bijë të vdekur!
Mjaft... mjaft qatë, mjaft bëtë viktimën,
Kështu nuk shkon,
Me lot zgjidhen vdekjet jo jetët...
Zëri duhet të ngrihet me piskamë, ta dëgjoje dhe qielli,
Që ti nuk duhet të rrih si e mjera e Kurtizanëve në shtëpi,
Nuk duhet të ngacmohesh seksualisht, nga disa specie mutacionesh.
Nuk duhet të dorëzohesh para askujt,
Por kryelartë, kryenece ashtu e pazbutur,
Ta lash dhimbjen me buzëqeshje.
Ta fshish lotin me mirësi.
Ti zbusësh plagët me ëndrra.
Le të thonë bushtë,
Le të nënvlerësojnë,
Le të bëjnë pabarazi gjinore
Le të të hedhin në humnerat më të ndyra të universit
Por mos harro, që karma eksiston dhe që ti je jetë,
Jeta është pjesë e vdekjes dhe vdekja pjesë e jetës, pra mashkulli ?
Plagët e pabarazisë gjinore,
Do ti lidhim me fashot e luftës,
Që të bëjmë luftën e jetës, luftën me kuptimplotë të ketij shekulli,
Që ta fitojmë,
Ta fitojmë,
Që femra të kthehet atje ku lindi, në fron, në fronin e jetës
Ne krye për të shkëlqyer...
Bota kur u ngjiz, u ngjiz e drejtë, pa barazi gjinore
Duhet të kthehemi në rrenjë,
Ne zanafillë,
Ne pikënisje,
Atëherë kur bota dha Adamin dhe Evën,
Dhe këtë herë,
Ti bëjmë gjërat sic duhet... pa plagë që sna duhen...

Adrian Zalla

Një trëndafil në shkretëtirë, hëna dritë dhënëse në një natë të zezë e të frikshme, burimi ku pikon ujë i bekuar i cili nuk shuhet kurrë, kjo është femra, e madje shumë më shumë se kaq.

Jam e sigurt se nëse u thua ëngjëjve të të përshkruajnë femrën do të thonë: "Femra ishte ëngjëlli më perfekt që jetonte në parajsë, prandaj dhe Zoti e dërgoi atje poshtë që ta mbronte atë botë nga demonët". Ah moj femër, si zbrite nga parajsa dhe re në prangat e djallit. Sa herë e kthej kokën pas një thikë e mprehtë më ther shpirtin. Shoh se si u përbuzte femra, një skllave "memece" e mashkullit. Shoh sa ëndrra kishte në sytë e saj e prapë ato ëndrra thyheshin kur i kujtonte vetes se ishte një femër, detyra e vetme e së cilës ishte t'i shërbente mashkullit. E di kush më dhemb më shumë nga të gjitha? Më dhemb kur shoh se si mashkulli vjen në shtëpi vonë, kush drejton e di se nga ku, e femrës, pikërisht asaj që e priti zgjuar pavarësisht lodhjes ai fillon ta godasë sepse kështu tregon burrërinë e tij. Përsëri ajo gjen forcë dhe buzëqesh për hir të fëmijëve të saj. Ah sa vuajtje mban mbi supet një femër. E vetmja gjë që më bën të lumtur është kur shoh se gjërat kanë ndryshuar. Sot e shoh femrën aty ku i ka hije. E shoh në shkollë duke mësuar barazinë midis gjërit-tjetrit, e shoh në gjykatë duke dënuar çdo njeri që ngriti dorën tek dikush më

i dobët njësoj siç bënin me të, e shoh në parlament duke bërë titur që njerëzit të dëgjojnë të drejtat e saj. Tani nuk mund ta trajtosh si skllaven tënde, sepse ajo është e fortë.

Ajo u ngrit nga ajo greminë e errët ku kishte rënë dhe ngjiti shkallët për të arritur në majë, pranë mashkullit, përpos dhimbjeve që ai i shkatoi, ajo i qëndron besnike duke udhëhequr të dy së bashku. Përsëri duhet shumë punë për të marrë vendin që i përket, por ajo lufton çdo ditë. Njësoj si një fluturë në një dhomë të errët që kërkon dritë për të qenë e lirë, unë e di që një ditë femra do e gjejë dritën që i takon, e kur të vijë ajo ditë, do të jetë "koha e femrës"...


Anjeza Mullahi

Unë femra,ti mashkulli

Kush jam unë?
Unë jam femër
një skllave që bindem.
Kush je ti?
Ti je mashkull,
ai që më përbuz
më shkakton dhimbje.
Ç'burrëri për mashkullin
kur femrën e qëllon.
Ç'poshtërsi për femrën
kur të drejtat e saj kërkon.
Ah sa shpejt që harron ti mashkull.
E mban mend se si një femër
të solli në këtë botë
e ti tani je aq burrë
sa e hedh si një leckë në tokë.
E mban mend si të këndonte ninulla
sa herë ti qaje
ajo u bë mburoja jote,
edhe atëherë kur pate faje.
Ajo të rriti me dashuri,
e ti tani je i rritur mjaftueshëm
tu falësh femrave vec mërzi.

Por unë e di
se femra është më shumë.
Sepse femra bën dot pa mashkullin,
por mashkulli pa femrën humb.
Atje lart në qiell
ëngjëjt ishin të tepërt
prandaj Zoti i solli këtu
në formën e femrës.
Por unë e di se ajo do ia dali
të luftojë për lirinë e saj.
Njësoj siç vjen
si një shpresë në mëngjes dielli,
ashtu do të vijë dhe koha e saj.

Anjeza Mullahi



Ana Bashalli

Arte Vizuale



Enkelana Mehmeti
Arte Vizuale



Erlisa Nezaj
Arte Vizuale



Florie Axhami
Arte Vizuale






Gresilda Bajrami

Arte Vizuale

Ibrahim Burgu

Arte Vizuale



Kozeta Ndreka

Arte Vizuale





Kristi Dushi

Arte Vizuale

Kristina Myftaraga

Arte Vizuale




Matilda Ndoj
Arte Vizuale



Rosela Nikolla

Arte Vizuale




Vilma Mirakaj
Arte Vizuale





Xhemal Kodragjini

Arte Vizuale



*You
are
pretty*

Xhensilda Ndreka

Arte Vizuale



Xhoana Marku

Arte Vizuale



**Raiffeisen
INVEST**

LIVING WITH GENDER EQUALITY

BOOKLET

Qendra ACT for SOCIETY/ ACT for SOCIETY Centre

Address: Rruga "Derhemi", Pallati "SONY", Kati I

Tiranë, Shqipëri / Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 44507447

www.actforsocietycenter.org